

1 E hënë, 11 prill 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi.

7 Z. Sekretar i Gjykatës, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar.

9 Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokuroria e Specializuar  
10 kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së  
12 pari, ju lutem të paraqisni kush është i pranishëm.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar.  
14 Mirëmëngjesi. Prokuroria e Specializuar përfaqësohet sot nga  
15 Prokurori, Cezary Michalczuk; Line Pedersen, Menaxhere e  
16 Lëndës; dhe unë, Silvia D'Ascoli, Ndhmësprokurore.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Mbrojtësja e Viktimave, fjala është për ju.

19 ZNJ. VOSENBERG:[Përkthim] Mirëmëngjes. Ne përfaqësohemi  
20 sot nga unë Brechtje Vossenber, Bashkmbrojtëse.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Avokati Mbrojtës, fjala është për ju.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar. Mbrojtja  
24 përfaqësohet nga Bashkëmbrojtësi, Betim Shala; unë, Julius Von  
25 Bone; dhe përkthyesi dhe hetuesi, Z. Fatmir Pelaj. Edhe po

1 ashtu kemi të pranishëm z. Mustafa në sallën e gjyqit sot.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit. Për procesverbal, jeni para Trupit Gjykses I.

4 Sot do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes z.  
5 900, z. Kapllan Parduzi. Para kësaj, megjithatë, Trupi Gjykses  
6 dëshiron të flasë për tre aspekte me palët dhe me  
7 pjesëmarrësit.

8 Pikë së pari, do të nxjerrim një urdhër gojor.

9 Më 7 prill 2022 të këtij viti, Trupi Gjykses mori rendin  
10 e rishikuar të dëshmitarëve nga Mbrojtja për muajt prill dhe  
11 maj 2022, që është parashtrimi i protokolluar F373, në të  
12 cilin nuk përmendej Dëshmitari i Mbrojtjes 1200 dhe 1900.

13 Në të njëjtën ditë, me email që u dërgua nga NJAGJ-ja tek  
14 Mbrojtja, në orën 18.18, Trupi Gjykses i kërkoi Mbrojtjes që  
15 të qartësonte nëse synonte dhe kur synonte të thërriste  
16 dëshmitarët 1200 dhe 1900.

17 Më 8 prill 2022, Mbrojtja u përgjigj përmes emailit në  
18 orën 07.54 të mëngjesit se nuk synonte t'i thërriste më  
19 dëshmitarët 1200 dhe 1900. Mbrojtja shtoi më tej lidhur me  
20 dëshmitarët 1400 dhe 1500 se priste që pyetjet e tyre të  
21 zgjasnin rreth dy orë dhe jo tre orë siç ishte parashikuar  
22 fillimisht në parashtrimin e protokolluar F373.

23 Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja ka detyrim që të  
24 njoftojë Trupin Gjykses nëse synon të ndryshojë listën e  
25 dëshmitarëve. Kjo bazohet në rregullin 119(5) e Rregullores.

1 Avokati i Mbrojtjes nuk veproi siç duhet në këtë situatë dhe e  
2 informoi Trupin Gjykses vetëm kut ja kërkuan. Sidoqoftë, Trupi  
3 Gjykses urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë listën e ndryshuar të  
4 dëshmitarëve në të dhënat e çështjes gjyqësore brenda të  
5 martës, 12 prill 2022. Në listë duhet përfshirë edhe koha e  
6 rishikuar për pyetjet për dëshmitarët 1400 dhe 1500.

7 Kjo mbyll urdhrin gojor nga Trupi Gjykses.

8 Tani sa i takon pikës së dytë, po ashtu për Mbrojtjen.  
9 Trupi Gjykses i kërkon Mbrojtjes të konfirmojë nëse i akuzuari  
10 do të bëjë deklaratë pa betim në bazë të rregullit 142,  
11 paragrafi 1 i Rregullores. Trupi Gjykses e kupton se në rast  
12 se ndodh kjo, deklaratë pa betim do të bëhet pas dëshmisë së  
13 dëshmitarit të fundit të Mbrojtjes, që është parashtrimi i  
14 protokolluar 335, paragrafi 5.

15 Trupi Gjykses dëshiron të dëgjojë prej Mbrojtjes, 1, nëse  
16 i akuzuari dëshiron të bëjë deklaratën pa betim në javën e 17  
17 [sipas përkthimit] majit, pra, 17, 18, 19 maj; B, cila është  
18 kohëzgjatja e parashikuar e deklaratës; dhe, C, nëse i  
19 akuzuari do t'i përgjigjet pyetjeve nga Trupi Gjykses para apo  
20 pas dhënies së deklaratës.

21 Avokat Mbrojtës, a jeni gati t'i përgjigjeni tani apo ta  
22 shtyjmë për nesër paradite?

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Më mirë ta shtyjmë për nesër  
24 paradite, e nderuar Gjykatëse, që të konsultohem me ekipin.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë.

2 Sekretar i Gjykatës, mund të shkojmë në seancë private,  
3 ju lutem.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes

11 900, numër 900.

12 Për procesverbal, kemi lejuar të bëjmë pyetjet në shqip,  
13 të drejtojmë pyetjet në shqip, këtë leje e kemi dhënë me email  
14 të premtën e kaluar.

15 Z. Shala, jeni ju që do të drejtoni pyetjet?

16 Z. SHALA: [Përkthim] Po, e nderuar.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

18 t'i them dëshmitarit dhe do të këmbëngul, që është shumë e  
19 rëndësishme të presim pesë sekonda mes pyetjes dhe përgjigjes.

20 Të bëjmë të pamundurën të ndihmojmë dëshmitarin të veprojë siç  
21 duhet në mënyrë që të hedhim çdo gjë në transkript çdo gjë që  
22 thuhet. Prandaj do ju lutesha edhe ju që të bëjmë të

23 pamundurën ta bëjmë të funksionojë, sepse javën e fundit,

24 seancat e -- ishte pak e vështirë për të gjithë që të merrnim

25 -- që të kishim mundësi t'i zbardhim të gjitha në transkript.

1 Kështu që ju lutem kur të përgjigjet dëshmitari, prisni  
2 pak dhe pastaj bëni pyetjen tjetër.

3 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.  
4 Do bëj të pamundurën.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të  
6 gjithë bashkë.

7 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem silleni dëshmitarin  
8 në sallën e gjyqit.

9 [Dëshmitari hynë në sallën e gjyqit]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
11 Parduzi, mirëmëngjes dhe mirë se erdhët në Dhomat e  
12 Specializuara. Si jeni?

13 DËSHMITARI: Mirë se ju gjetëm. Mirë, faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh  
15 që na dëgjon mirë.

16 DËSHMITARI: Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
18 mirë.

19 Ju kemi thirrur të dëshmoni në Dhomat e Specializuara në  
20 çështjen kundër z. Salih Mustafës, në mënyrë që ta ndihmoni  
21 Trupin Gjykses të marrë vendimin e duhur.

22 Pasi të bëni deklaratën për të thënë të vërtetën, do ju  
23 bëjnë pyetje nga Avokatët Mbrojtës që përfaqësojnë z. Mustafa,  
24 që janë në të djathtën tuaj. Pastaj do ju bëjnë pyetje nga  
25 përfaqësuesit e Prokurorisë, në të majtën tuaj, që janë pranë

1 Gjykatësve, pra, në anën që po tregon me dorë Gjykatësja. Dhe,  
2 pastaj do ju bëjnë pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave, që janë  
3 po ashtu në të majtën tuaj, nëse do të ketë pyetje. Dhe, në  
4 fund, mund t'ju bëjë pyetje Trupi Gjykues.

5 E kuptoni këtë?

6 DËSHMITARI: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
8 mirë.

9 Do të doja t'ju jepja disa këshilla për mënyrën sesi t'i  
10 përgjigjeni pyetjeve.

11 Z. Parduzi, -- mirë po e them z. Parduzi jeni --

12 DËSHMITARI: Parduzi.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Parduzi. Shumë mirë. Ju lutem, dëgjoni me vëmendje secilën  
15 pyetje. Nëse nuk e kuptoni, thoni pa siklet që pyetjen ta  
16 përsërisim. Thoni të vërtetën çfarë keni parë, çfarë keni  
17 dëgjuar, çfarë keni përjetuar ju vetë. Nëse e keni zbuluar në  
18 forma të tjera, na e thoni si e keni marrë vesh dhe na e  
19 shpjegoni.

20 Mbase nuk do t'i mbani mend të gjitha të dhënat e  
21 ngjarjeve dhe është krejt normale. Ju lutem dëshmoni bazuar me  
22 ato çka mbani mend dhe është krejt normale të thoni "S'e mbaj  
23 mend", "S'e di", mos supozoni dhe mos sajoni gjëra.

24 Ju lutem përgjigjuni pyetjeve në mënyrë të përqendruar.  
25 Nëse ka nevojë që ne të marrim qartësime, do ju themi t'i



1 qartësoni. Mund t'ju ndërpres nëse devijoni në përgjigjen tuaj  
2 dhe nuk i përgjigjeni asaj që ju është pyetur. Gjithashtu ju  
3 kujtoj se mund të refuzoni t'i përgjigjeni pyetjeve për  
4 çështje që mund t'ju inkriminojnë ju vetë.

5 E kuptoni? I kuptoni këto?

6 DËSHMITARI: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
8 mirë. Gjithashtu disa këshilla praktike për dëshminë tuaj.

9 Çdo gjë që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet, është  
10 e rëndësishme të flisni para mikrofonit, të flisni qartë dhe  
11 të flisni ngadalë. Kjo i ndihmon përkthyesit që t'i përkthejnë  
12 të gjitha gjërat që thuhet.

13 Duhet të filloni të flisni vetëm kur personi që ju ka  
14 bërë pyetjen ka mbaruar. Dhe kur ju bëj një pyetje, z.  
15 Parduzi, numëro në kokën tënde deri në pesë dhe pastaj  
16 përgjigju edhe këmbëngul tek kjo pesë. Është shumë e  
17 rëndësishme. Dhe ky pesë sekondëshi është shumë i rëndësishëm  
18 për ne të ndjekim siç duhet atë që po na thoni.

19 Dhe kur pyetjen do jua bëjë z. Shala dhe kur të mbarojë  
20 pyetjen, prisni pesë sekonda, z. Parduzi. Është shumë e  
21 rëndësishme. Mund të më duhet t'ju ndërpres, se kur e dëgjon  
22 pyetjen shqip, imagjinoj që instinktivisht dëshiron t'i  
23 përgjigjesh menjëherë, por prit pesë sekonda dhe pastaj  
24 përgjigju.

25 Nëse e ngre dorën unë, ju lutem mos flisni, ndërprisni,

1 pra, së foluri. Nëse flas te mikrofoni, do mbivendosim ato që  
2 themi, kështu që preferoj të mos e bëjmë këtë gjë. Ndonjëherë  
3 do ju kërkojmë të hiqni kufjet, dëgjueset ose mund t'ju  
4 shoqërojmë jashtë sallës kur është nevoja të diskutojmë diçka  
5 lidhur me përmbajtjen e dëshmisë, në mënyrë që të mos kemi  
6 ndikim tek ju.

7 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim apo  
8 çfarëdolloj ndihme tjetër, ju lutem ngrini dorën edhe do ju  
9 jap fjalën në mënyrë që të bëni pyetjen përkatëse.

10 I kuptuat të gjitha këto?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
13 mirë.

14 Flisni anglisht, z. Parduzi?

15 DËSHMITARI: Jo.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
17 shënuam. Faleminderit.

18 Si me çdo dëshmitar, tani do ju kërkoj që të lexoni  
19 betimin tuaj që do të thoni të vërtetën. Dhe ju kujtoj se  
20 është vepër penale në juridiksionin e Dhomat e Specializuara  
21 në qoftë se jepet dëshmi e rreme. E keni kuptuar këtë?

22 DËSHMITARI: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
24 rregull.

25 Ju lutem, ndihmoni dëshmitarin të lexojë betimin.

1 Ju lutem, z. Parduzi, lexoni tekstin që keni përpara.

2 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime  
3 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të  
4 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe  
5 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

6 DËSHMITARI: KAPLLAN PARDUZI

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, z. Parduzi. Tani jeni nën betim për të thënë të  
9 vërtetën.

10 Tani do të fillojmë me dëshminë e z. Parduzi, duke  
11 filluar me pyetjet nga Avokatët Mbrojtës.

12 Avokat Mbrojtës, keni kërkuar parashikuar rreth dy orë  
13 për pyetjet për këtë dëshmitar. Si zakonisht, ju lutem nëse  
14 keni ndryshime për qëllime planifikimi njoftojeni Trupin  
15 Gjykues. Fjala është për ju.

16 Z. SHALA: [Përkthim] Po, e nderuar. Kështu do të bëjmë.

17 Pyetje nga Z. Shala:

18 Py. Mirëdita, z. Dëshmitar.

19 Pë. Mirëdita.

20 Py. Z. Dëshmitar, a i keni dhënë Mbrojtjes së Salih Mustafës  
21 deklaratë?

22 Pë. Po.

23 Py. A ju kujtohet kur e keni dhënë këtë deklaratë?

24 Pë. Po.

25 Py. A mund të na tregoni kur e keni dhënë?

1 Pë. Më 26 shkurt 2021.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Dëshmitar, prisni pak. Prisni pak. Prisni pak, para se të  
4 përgjigjeni ju lutem.

5 Z. SHALA:

6 Py. Përveç që Mbrojtjes i keni dhënë deklaratë, dikujt tjetër  
7 ai keni dhënë deklaratë në atë periudhë kohore? Po flas për  
8 vitin 2021 dhe tani për vitin 2022.

9 Pë. Po, kam qenë i kontaktuar në dhjetor, në mesin e  
10 dhjetorit 2021 nga Prokuroria dhe më 10 janar 2022 kam qenë në  
11 intervistë në Fushë Kosovë, në zyrat e EULEX-it.

12 Py. Në çfarë cilësie keni qenë i ftuar?

13 Pë. Po nuk e di cilësinë edhe pse m'u ka duk e padrejtë edhe  
14 atëherë edhe tash. Meqenëse ju filluat me pyetjet, unë deshta  
15 para Trupit Gjykes, t'i ngriti dy shqetësime personale dhe  
16 reale besoj që janë, personale të miat, nëse më lejohet.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
18 momentin duhet t'i përgjigjeni vetëm pyetjeve që ju bën  
19 Avokati Mbrojtës.

20 Z. SHALA:

21 Py. Z. Parduzi, do të dëshiroja që me ju sot të flasim për  
22 periudhën kohore të vitit 1998 dhe vitit 1999. A keni qenë  
23 pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

24 Pë. Po, kam qenë.

25 Py. Nga cilla kohë jeni ushtar i Ushtrisë çlirimtare?

1 Pë. Jam nga maji i vitit 1998 e gjer më tani.

2 Py. A ju kujtohet në cilën pjesë të Kosovës i jeni bashkuar  
3 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

4 Pë. Po.

5 Py. Në cillën pjesë?

6 Pë. Në zonën operative të Llapit.

7 Py. Në vitin 1998, në kohën kur ju i jeni bashkangjit

8 Ushtrisë Çlirimtare në zonën operative të Llapit, a kanë  
9 ekzistuar brigadat në atë kohë?

10 Pë. Jo, nuk kanë ekzistuar. Brigadat janë formuar ma vonë.

11 Py. A mund të na tregoni kur janë formuar?

12 Pë. Nuk e di. Të them të drejtën sepse nuk kam qenë i thirrun  
13 unë, po mendoj dikun ka fundi i gushtit 1998.

14 Py. Në kohën kur janë -- sa brigada janë formu në atë kohë?

15 Pë. Janë formu dy brigada: Brigada 151, Zahir Pajaziti; dhe  
16 152, Shaban Shala. Kurse në nivel të zonës kanë qenë tri  
17 brigada, por Brigada 153 është formue në 1999, diku nëse  
18 s'gaboje ka shkurti o atje dikun.

19 Py. Ju cilës brigadë i keni taku pas themelimit, formimit të  
20 brigadës?

21 Pë. Unë i kam taku Brigadës 151, Zahir Pajaziti.

22 Py. Në atë kohë ku e ka pasë selinë brigada, shtabi i  
23 Brigadës 151?

24 Pë. Kemi qenë të vendosur në shkollën e Bajgores, në Bajgore.

25 Py. Dhe a keni qenë gjatë tërë kohës deri në qershor të vitit

1 1999 në atë pjesë në Bajgore?

2 Pë. Jo. Kemi qëndruar deri më 19 ose 20 shtator sepse unë më  
3 15 shtator 1998, ka qenë ofensiva e parë e ballafaqimit mes  
4 forcave serbe dhe UÇK-së në fshatin Kaçanoll apo në Grykën e  
5 Kaçanollit në vijën ku e ndan territorin e Komunës së Llapit  
6 edhe të Mitrovicës.

7 Py. Dhe pastaj ku shkuat?

8 Pë. Brigada 151, jemi vendos në fshatin Bradash.

9 Py. Ju në atë kohë keni pasë ndonjë pozitë, ndonjë gradë në  
10 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës?

11 Pë. Po, e kam pasë gradën ma të lartë e cila ka ekzistue në  
12 Ushtrinë Çlirimtare.

13 Py. A mund të na e tregoni?

14 Pë. Ushtar i Ushtrisë Çlirimtare. Gradë ma të lartë s'ka  
15 pasë.

16 Py. Me themelimin e Brigadës 151 dhe 152, a ju kujtohet kush  
17 janë emëruar komandant të atyre dy brigadave?

18 Pë. Po.

19 Py. A mund të na i tregoni kush janë?

20 Pë. Brigada 151 fillimisht ka qenë komandant Nuredin Ibishi,  
21 Leka. Kurse në Brigada 152, Shaban Shala ka qenë, Idriz  
22 Shabani me pseudonimin Luta.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Dëshmitar.

25 DËSHMITARI: Urdhno.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Dëshmitar, të lutem prit pak, pak, para sesa t'i përgjigjesh  
3 pyetjes së avokatit, sepse për përkthyesit është pak e  
4 vështirë nëse përgjigjesh menjëherë. Pak, pak mes përgjigjes  
5 dhe pyetjes pak kohë.

6 Ju lutem vazhdoni, Avokati Mbrojtës.

7 Z. SHALA:

8 Py. Z. Dëshmitar, thatë Nuredin Ibishi fillimisht ka qenë i  
9 caktum për komandant i Brigadës 151. Çka do të thotë kjo  
10 fillimisht?

11 Pë. A mundesh specifikisht? Kur asht formu Brigada 151 ka  
12 qenë komandant Nuredin Ibishi, në fillesat e sajna.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Avokati Mbrojtës, më duhet të them dhe unë çfarë nënkupton  
15 kjo? Çfarë? Ku do të dalësh? Cila është pyetja për  
16 dëshmitarin?

17 Mund t'ia bëni pyetjen dëshmitarit, po bëjeni më  
18 konkrete, më të qartë.

19 Z. SHALA:

20 Py. A do të thotë kjo që Nuredin Ibishi nuk ka qenë komandant  
21 deri në qershor të vitit 1999 i Brigadës 151?

22 Pë. Më fal. Dua dhe një herë ta sqaroj. Nuk është formu  
23 Brigada 151 në qershor të 1998. Është formue, thashë, në  
24 gusht, ka mesi i gushtit 1998.

25 Py. Po. Po pyetja ime ishte, a ka qenë komandant deri në

1 qershor të vitit 1999 i Brigadës 151?

2 Pë. Jo.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

4 Avokat Mbrojtës - mund t'i hiqni pak kufjet ju lutem - deri

5 kur -- mund t'i bënin pyetjen deri kur ishte z. Leka komandant

6 i Brigadës 151 dhe kështu mund të marrim dhe përgjigjen, se ne

7 prapë s'po e marrim vesh përgjigjen. Ne e marrim vesh që

8 s'është deri në fund. Po mund ta pyesni deri kur ishte?

9 Ju lutem, vendosini prapë kufjet. Z. Dëshmitar, vendosi  
10 prapë kufjet. Faleminderit, z. Dëshmitar.

11 Z. SHALA:

12 Py. Dhe deri kur ka qenë komandant Nuredin Ibishi i Brigadës  
13 151?

14 Pë. Nuk mund ta them me saktësi, por besoj dikun ka fundi  
15 nëntorit, fillimi dhjetorit 1998 është avancue në shef shtabi  
16 të Zonës Operative të Llapit.

17 Py. Dhe pas tij kush është emëru komandant i Brigadës 151?

18 Pë. Komandant i Brigadës 151 është emërue, është zëvendësu,  
19 në fakt, e ka marrë Idriz Shabani, Luta. Kurse 152-shin, e ka  
20 marrë Arif Muçolli, Profa.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

22 Dëshmitar, a mund të përsërisni edhe njëherë emrin e Brigadës  
23 152?

24 DËSHMITARI: Brigada 152, Arif Muçolli, me pseudonimin

25 Profa.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Z. SHALA:

4 Py. Z. Dëshmitar, Salih Mustafën nga cilla periudhë kohore e  
5 njifni?

6 Pë. Fizikisht, e njoh prej 1998. Kurse si Salih, e njof shumë  
7 ma herët nëpërmes mediave sepse ka qenë i ndjekur dhe i  
8 përndjekun. Ka shkru edhe shtypi. E kam njof përmes shtypit si  
9 emën, si figurë, por fizikisht në 1998.

10 Py. Ku e keni taku fillimisht, që thatë në vitin 1998, në  
11 qoftë se ju kujtohet?

12 Pë. Mund të jem i gabuar por ose në Bajgorë, ose në Zaberxhë.  
13 Ka gjasa ma të mëdhaja që të Bajgora, sepse në atë kohë,  
14 sillte njerëz që dojshin të kyçen në Ushtrinë Çlirimtare të  
15 Kosovës në radhët e saj dhe i prunte për ushtrime ushtarake.

16 Py. A ju kujtohet a ke keni pasë kontakt personal dhe sa ka  
17 zgjatë ai kontakt nëse e keni pasë?

18 Pë. Po, kam pasë kontakt sepse ka qenë absurditet të mos  
19 takoheshim. Jemi përshëndet. Ka zgjatë, po ju them, maksimumi  
20 mund të jetë një orë, maksimumi, po mund të ketë gjasa edhe ma  
21 pak, por jo mbi një orë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

23 Avokat.

24 Z. Dëshmitar, hiqini pak dëgjueset.

25 A mund t'i bëni pyetjet më specifike për sa i përket

1 afateve kohore, se këtu shoh që e ka takuar fillimisht në  
2 1998. Këtu i shoh përgjigjet që ka bërë ai, por për cilin afat  
3 kohor bëhet fjalë, për cilën periudhë kohore?

4 Z. SHALA:

5 Py. Z. Dëshmitar, thatë që Salih Mustafën e keni takuar në  
6 vitin 1998. A ju kujtohet data apo së paku muaji i vitit 1998  
7 që e keni taku Salih Mustafën?

8 Pë. Jo, data nuk po më kujtohet, sepse nuk kemi mbajtur shënim.  
9 Muaji mund të ketë qenë korriku. Megjithatë, po e them një,  
10 mund të jetë korriku ma i përafërt, po jo, nuk jam i saktë.

11 Py. Gjatë atij takimi, a jeni interesu për veprimtarinë e  
12 Salih Mustafës në periudhën kohore të vitit 1998?

13 Pë. Më vjen keq por specifikona pyetjen. Veprimtaria e Salih  
14 Mustafës ka qenë veprimtari edhe e imja. Sepse kemi qenë -- e  
15 kemi pasë një qëllim. Ka qenë gjejsha e radhëve të ushtarëve  
16 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ka qenë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
18 Avokat.

19 Z. Dëshmitar, hiqini dëgjueset ju lutem.

20 Në faqen 16, rreshti 11, ju thatë:

21 "Gjatë këtij takimi..."

22 Megjithatë, me sa kuptova unë, dëshmitari thotë që e ka  
23 takuar disa herë z. Mustafa. Prandaj bëjini pyetjet pak më të  
24 sakta. Ndoshta keni parasysh diçka tjetër. Po kjo është pak sa  
25 konfuzuese. Këtu nuk flitet për të njëjtin takim.

1 Z. SHALA: [Përkthim] Po, bëhet fjalë për 1999, herën e  
2 parë që e ka takuar gjatë asaj kohe.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
4 është e qartë. Dua të dëgjoj informacione të sakta nga  
5 dëshmitari. Nuk dua të ndërhyj në mënyrën si i bëni ju pyetjet  
6 por dua thjesht që t'i kem të sakta.

7 Z. SHALA:

8 Py. Z. Dëshmitar, thatë që në muajin korrik 1998 e keni  
9 takuar për herë të parë Salih Mustafën fizikisht dhe thatë që  
10 ky takim ka zgjatë përafërsisht një orë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Prisni. Prisni.

13 Z. Parduzy, hiqini dëgjueset ju lutem.

14 Nuk e tha ky që ishte në korrik. Ai tha që "Afërsisht  
15 mendoj që mund të ketë qenë". Nuk tha ai që ishte në korrik të  
16 1998.

17 Z. SHALA: [Përkthim] Edhe pyetja ime ishte afërsisht në  
18 korrik.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
20 nuk është përkthyer. Ju kërktoj ndjesë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.

22 Z. Dëshmitar, më vjen keq që duhet që t'i hiqni de t'i  
23 vini dëgjueset gjatë gjithë kohës, por është më mirë që ju të  
24 mos i dëgjoni pyetjet që bëj unë. Tani mund t'i mbani. Mund  
25 t'i mbani. Faleminderit, z. Dëshmitar.

1 Z. SHALA:

2 Py. Z. Dëshmitar, më vjen keq që duhet ta përsëris përsëri  
3 pyetjen. Ju thatë që për afërsisht rreth muajit korrik të vitit  
4 1998, për herë të parë e keni takuar Salih Mustafën fizikisht.

5 A ju kujtohet gjatë këtij takimi, a keni biseduar me Sali  
6 Mustafën për aktivitetet e tija si ushtar i Ushtrisë  
7 Çlirimtare?

8 Pë. Unë e thashë edhe po e ripërsëris, aktivitetet e Salih  
9 Mustafës kanë qenë edhe të miat edhe të çdo ushtari të  
10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kështu që rreth asaj tematike,  
11 nuk kemi pasë çka të bisedojmë, sepse kanë qenë të njohura çka  
12 duhet të bëjmë.

13 Py. A je interesu për ata ushtarë, rekrutë, që i ka sjellë  
14 aty në çfarë mënyre në çfarë forme i ka kontaktuar dhe i ka  
15 sjellë aty?

16 Pë. Po mendoni për Salih Mustafën?

17 Pë. Po, për Salih Mustafën.

18 Pë. Nuk e di. Por në bazë të asaj rrjedhshmërisë që kanë shku  
19 ngjarjet, kanë qenë të gjithë vullnetarë të paraqitun edhe  
20 është dashtë njerëz që kanë qenë në rrjedha i kanë sjellë për  
21 ushtrime ushtarake. Sepse pjesa dërrmuese e tyre ka qenë moshë  
22 e re që nuk e kanë kryer shërbimin ushtarak dhe s'kanë pasë  
23 njohuri rreth armatimit dhe përdorimit të tyre. Kështu që e  
24 kanë krye trajnimet dhe mvarësisht prej kushteve e rrethanave  
25 i kemi angazhuar. Por çdo herë mbi baza vullnetare.

1 Py. A e keni ditë nga cilli regjion i Kosovës i ka sjellë ata  
2 rekrutë?

3 Pë. Kosova ka qenë një edhe e pandashme. Sigurisht pjesa 99.9  
4 për qind ka qenë pjesës së Prishtinës me rrethina, me fshatra.

5 Py. Pse jeni kaq i sigurtë që ata rekrutë kanë qenë 99 për  
6 qind të pjesës së Prishtinës dhe rrethinës?

7 Pë. Po besoj që kanë qenë. Ka mujtë me qenë edhe viseve tjera  
8 nëse kanë qenë student nëpër universitete edhe me u kyç. Por  
9 besoj që pjesa dërrmuese ka qenë e këtyre rretheve. Kjo është  
10 bindja ime. Mund të jem i gabuar. Sepse s'ia kam marrë  
11 gjeneralit që t'i shoh dhe t'i verifikoj ku është, nga është.

12 Py. Në korrik të vitit 1998, a e keni ditur në cillën pjesë  
13 të Kosovës ka vepruar Salih Mustafa si ushtar i Ushtrisë  
14 Çlirimtare të Kosovës?

15 Pë. Unë po besoj që pyetja është e përgjithshme, sepse e tërë  
16 Kosova ka pasë nevojë. Edhe aty ku është paraqit nevoja, çdo  
17 kush e ka dhënë kontributin e vet në forma apo në mënyrat e  
18 veta të mundshme. Nuk e di, por jam i bindur thellë që  
19 orientimin kryesor dhe fokusin e ka pasë në zonën operative të  
20 Llapit.

21 Py. Gjatë vitit 1998 dhe deri në qershor të vitit 1999, ju  
22 personalisht, a keni qenë në fshatin Zllash?

23 Pë. Po, kam qenë.

24 Py. A keni qenë -- sa herë keni qenë?

25 Pë. Në 1998 kam qenë njëherë. I kemi dërguar do armë dhe do

1 municion. Dhe në 1999 kam qenë nja dy ose tre herë. Gjithsej  
2 katër-pesë herë.

3 Py. Herën e parë kur keni shku në Zllash, në vitin 1998, a ju  
4 kujtohet përafërsisht në cillin muaj apo datë të vitit 1998  
5 keni qenë aty?

6 Pë. Datat janë shumë të rralla që na mbahet mend. Sepse nuk  
7 kemi qenë në një situatë që të mbajmë ditar edhe shënime edhe  
8 të shkruajmë datat, sepse ka qenë jeta tepër dinamike dhe  
9 ngjarjet janë zhvilluar shumë dinamike, fatkeqësitë kanë qenë  
10 edhe dramatike. Por, nëse s'gaboj, ka qenë dikun tetori i  
11 1998, fundi i tetorit të 1998. I kam dërgue disa armë, do  
12 municion edhe kam marrë ndihma veshmbathje, ushqimore prej  
13 Zllashit sepse ka qenë një qendër, pikë grumbulluese, e  
14 ndihmave për nevoja të tërë zonës.

15 Py. A ju kujtohet se në cillin vend jeni pajis me atë  
16 armatim?

17 Pë. Edhe pse prapë pyetja është e përgjithshme, megjithatë po  
18 i përgjigjem, por armatimin e kam marrë në Brigadën 151 në  
19 Bradash.

20 Py. Sa larg është Bradashi prej Zllashit?

21 Pë. Nuk di ta them sa është larg në vijë ajrore, por rrugën  
22 të cillën është dashtë ta kalojmë, ka qenë bukur e gjatë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Avokat.

25 Z. Dëshmitar, thatë që "Nuk e di në vijë ajrore". Çfarë

1 deshët të thoni me këtë?

2 DËSHMITARI: Vijë ajrore prej Bradashit në Zllash, nuk e  
3 di sa e ka. Por e di rrugën të cillën është dashtë me e  
4 tejkalu. Ka qenë rrugë e gjatë, e mundimshme. Sepse ne nuk i  
5 kemi përdorë rrugët magjistrale, po i kemi përdorë rrugët  
6 dytësore.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur  
8 thoni "shumë larg", a mund ta jepni pak më konkretisht? Pasi  
9 është një vlerësim i juaji ky, i veti. Ajo që ju thoni që  
10 është larg apo largësi e madhe, mund të mos jetë largësi e  
11 madhe për dikë tjetër. Pra, sa kohë do të duhet për shkuar në  
12 atë vend me këmbë, me makinë?

13 DËSHMITARI: Po për juve është absurditet të thuhet që  
14 ndoshta për me kalu atë rrugë është dashtë me bë diku 12 orë,  
15 13 orë. Ka njëherë edhe një ditë. Kurse në kushte normale me  
16 përdorë rrugët magjistrale shkon për një orë e gjysëm. Por  
17 s'kemi mat na dhe nuk mund të them unë ka kaq apo kaq.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
19 po kërkoja që të më tregonit distancën ekzakte, z. Parduzi.  
20 Doja të dija, për atë periudhë kohe, për të cilën po flasim,  
21 nëse do të duhej të shkoje në Zllash, sa kohë do t'ju duhej  
22 juve për të arritur atje me transportin që kishit, me mjetet e  
23 transportit që keni pasur. Dhe unë nuk po vlerësoj këtu nëse  
24 diçka është absurde apo jo. Unë thjesht po përpiqem të kuptoj  
25 nga ato që po dëgjoj.

1 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare, është vështirë që ta kuptoni  
2 sepse është e pamundur që edhe të bëhet një përshkrim i saktë.  
3 Megjithatë, unë po bëj përpjekje që të tregoj. Ajo ka qenë një  
4 rrugë që, sigurisht, minimumi kap shtatë orë. Mu më ka ndodhë  
5 që dhe 24 orë, mvarësisht prej kushteve e rrethanave që janë  
6 paraqit në rrugë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtu  
8 e ke fjalën me këmbë, me makinë, me zëtor, me traktor?

9 DËSHMITARI: Jo, me makinë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Faleminderit, z. Dëshmitar.

12 z. Avokat, ju e keni fjalën.

13 Z. SHALA:

14 Py. Pasi e keni dorëzuar armatimin dhe i keni marrë ushqimin  
15 dhe mjetet tjera që i përmendët, batanije, ku i dërguat ato  
16 pastaj?

17 Pë. Ato i dërgova në Bradash, në depon e Brigadës 151, Zahir  
18 Pajazitit, te depoisti.

19 Py. Z. Dëshmitar, dëshiroj të kthehem pak në muajin korrik të  
20 vitit 1998. Përafërsisht ku thatë që gjatë atij muajit,  
21 përreth muajit korrik përafërsisht të vitit 1998 e keni taku  
22 Salih Mustafën. Rekrutët që i ka sjellë Salih Mustafa, a e  
23 kanë përfunduar trajnimin, në qoftë se ju kujtohen?

24 Pë. Po, që të gjithë e kanë përfunduar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.



1 Avokat, duhet t'ju bëj një pyetje.

2 Z. Dëshmitar, ju lutem hiqini dëgjueset.

3 Avokat, po i sillemi rreth periudhës së 1998 tani për ca  
4 kohë. Këto pyetje si ndërlidhen me çështjen që ju doni të  
5 krijoni, të mbroni këto?

6 Z. SHALA: [Përkthim] E para, duam t'i tregojmë që  
7 dëshmitari e njeh vërtet Salih Mustafën dhe e njehë nga ajo  
8 kohë. Dhe dua të kuptoj tani se përse ka shkuar Salih Mustafa  
9 në Zllash në atë periudhë, pasi deri tani e ka përmendur që e  
10 ka parë vetëm në Bajgore.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
12 kuptoj, por ju tani po pyesni për stërvitjen e personave të  
13 sjellë.

14 Z. SHALA: [Përkthim] Pra, këto rekrutë i kanë shkuar ku  
15 ishte Salih Mustafa apo diku tjetër.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
17 Dakord vazhdoni, por do të ishte mirë që në një pikë të  
18 caktuar të afrohem me pikat të Aktakuzës.

19 Faleminderit, z. Parduzi.

20 Z. SHALA: [Përkthim]

21 Py. Rekrutët të cilët e kanë përfunduar trajnimin dhe ata të  
22 cillët i ka sjellë Salih Mustafa, a keni njohuri dhe a e dini,  
23 a janë kthyer në njësi të Salih Mustafës apo kanë shkuar dikun  
24 tjetër në ndonjë njësi tjetër apo brigadë tjetër?

25 Pë. Jo, nuk kanë shku në njësit. Sepse kur janë formuar

1 brigadat ato kanë qenë në kompani. Ka pjesa dërrmuese e tyre  
2 janë sistemue nëpër Brigadën 151 dhe 152, kryesisht 152, kurse  
3 mund të ndodhë që të jetë shkue dhe një në njësitin e Salih  
4 Mustafës. Nuk e di. Nuk kam njohuri. S'mund ta konfirmoj. As  
5 s'un e pohoj, a s'un e mohoj.

6 Py. A e dini sa ka zgjatë ai trajnimi?

7 Pë. Minimumi 10 ditë, maksimumi 21 ditë.

8 Py. Faleminderit, z. Dëshmitar. Në kohën kur keni qenë në  
9 Zllash, kur e keni dërgu armatimin, a ju kujtohet kujt ja keni  
10 dorëzu atë armatim?

11 Pë. E kam dorëzue në atë ndërtesë, shtëpi, po e quajmë si  
12 shtab, sepse edhe çështja e shtabit po keqkuptohet. Ne e kemi  
13 quajtur shtab çdo shtëpi private, se ne s'kemi pasë kazerma,  
14 s'kemi pasë strukturë të mirëfilltë ashtu qysh pretendohet.  
15 Por kanë qenë disa individë aty. Në mesin e tyre ka qenë  
16 Fatmir Sopi. Dhe disa, nuk e di, një ka qenë Asllani, depoist,  
17 nëse s'gaboj mbiemrin. Tash është dëshmor. Nuk e di si e ka  
18 pasë emrin. Edhe ndërkohë ka ardhë Salih Mustafa.

19 Py. A ju kujtohet, a mund të na e përshkruani si dukej ajo  
20 shtëpia dhe rrethina rreth asaj shtëpie? A ka qenë e vetmja  
21 ndërtesë aty?

22 Pë. Po ka qenë e pyllëzume përreth. Një shpi njëkatëshe,  
23 përdhese, në fakt, s'që asnjë katëshe, po përdhese, me aq sa  
24 më kujtohet, sepse ne fare nuk kem hy as mbrena. Ka qenë kohë  
25 e mirë edhe ishte pyetje koha që u dukke me u kthye, prandaj

1 nuk kam hy mbrena. Por në shiqim të parë ashtu pej afërsisë,  
2 ka qenë shpi përdhese.

3 Py. A ka pasë shtëpia të tjera përveç asaj?

4 Pë. Në atë kohë edhe kur po flasim për 1998, unë s'kam kalue  
5 dhe nuk kam parë. 1999, po, i kam pa edhe ka pasë edhe shpia  
6 tjera. Sa ka qenë numri i tyre nuk e di, s'i kam numërue.

7 Py. Z. Dëshmitar, po pyes për shtëpinë që e thatë njëkatëshe,  
8 ku i keni dorëzua armët. Përreth asaj shtëpie, jo në fshatin  
9 Zllash, po përreth asaj shtëpie, a ka pasë shtëpia tjera?

10 Pë. Me sa më kujtohet mue, jo nuk ka pasë. Ka qenë e ndame.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
12 Parduzi, ju lutem lejoni pak, disa sekonda përpara se t'i  
13 jepni përgjigje pyetjes së avokatit, pasi ne duam të lexojmë  
14 se cila ishe pyetja. Dhe në qoftë se nuk e di se cila ishte  
15 pyetja, nuk arrij të vlerësoj në mënyrën e duhur edhe  
16 përgjigjen tuaj. Dakord?

17 DËSHMITARI: Dakord.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit.

20 Vazhdoni, z. Avokat.

21 Z. SHALA:

22 Py. Z. Dëshmitar, në kohën kur Nuredin Ibishi emërohet si  
23 shef i stafit në Shtabin e Përgjithshëm të Zonës Operative të  
24 Llapit, ju a keni mbetur në brigadë?

25 Pë. Ju lutem, nuk është pjesë e stafit Nuredin Ibishi dhe nuk

1 ka qenë, pjesë e stafit, gjithsesi, në të përgjithshëm, por  
2 është caktue shef i shtabit. Dhe unë kam shkue së bashku prej  
3 ditës së parë me Nuredin Ibishin e derisa dhe jemi plagos së  
4 bashku.

5 Py. A ju kujtohet kur ka ndodhë plagosja?

6 Pë. Po.

7 Py. A mund të na tregoni kur ka ndodhë?

8 Pë. Më 10 prill 1999. Që i bie, nuk e di a është koicidencë  
9 apo e qëllimshme, me ditë të shtunën e kalume bëhen 23 vite  
10 kurse me datë dje 23 vite. Dhe mbas 23 vite gjindem para  
11 Dhomave të Specializuara.

12 Py. Kjo plagosja ju kujtohet në cillin vend ka ndodhë?

13 Pë. Po. Në fshatin Surdull.

14 Py. Ditën që jeni plagos, a ka pasë luftime në fshatin  
15 Surdull?

16 Pë. Po, ka pasë luftime tërë ditën.

17 Py. Pasi që jeni plagosur, a ju kujtohet ku ju kanë dërgu?

18 Pë. Po, më kujtohet.

19 Py. A mund të na tregoni?

20 Pë. Ne jemi plagos më 10 prill, siç e thashë. Edhe gjatë  
21 luftimeve e sipër, ka qenë një popullatë e zhvendosur në  
22 Gollak mbi 40.000 qytetarë - kanë qenë pleq, plaka, gra,  
23 fëmijë - dhe me të mirat materiale të tyre që kanë pasë,  
24 dikush ka pasë kamion, dikush autobus, për me i shpëtue  
25 hordhive serbe.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
2 Pyetja ishte: Pasi u plagosët, a ju kujtohet se ku ju kanë  
3 dërgua? Pra, "ku ju kanë dërguar", kjo është pyetja. Ju lutem  
4 jepini përgjigje pyetjes që ju ka bërë Avokati.

5 A mund ta pyesni dëshmitarin se për cilin vit bëhet  
6 fjalë, pra, data 10 prill cilit vit i takon, pasi nuk e shoh  
7 në transkript.

8 Vazhdoni.

9 Z. SHALA:

10 Py. Thatë më 10 prill. Të cillit vit?

11 Pë. 1999.

12 Py. Edhe pasi jeni plagosur, a ju kanë mbartë nga vendi ku  
13 keni qenë duke luftuar?

14 Pë. Po, sepse unë kam qenë tepër rëndë i plagosur. Ka qenë  
15 edhe komandant Leka, por ma lehtë dhe ai ka vazhdue luftimet  
16 tërë ditën. Mu më kanë bart disa shokë në fshatin Turiqicë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

18 Dëshmitar, ju lutem e përsërisni edhe një herë emrin e fshatit  
19 ju lutem?

20 DËSHMITARI: Turiqicë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

22 Në rregull.

23 Z. Dëshmitar, jeni i përqendruar kur t'i përgjigjeni  
24 pyetjes. Mos shtoni informacione të tjera. Përgjigjuni  
25 pyetjes. Nëse kemi nevojë për sqarime të tjera, do t'ju pyesim

1 ne.

2 Ju lutem vazhdoni, Avokat i Mbrojtjes.

3 Z. SHALA:

4 Py. Z. Dëshmitar, ditën kur jeni plagos, a keni qenë prej ma  
5 herët, prej asaj dite ma herët në Surdull apo keni shkuar aty?

6 Pë. Jo, kemi shkue në fund të marsit, ka fillimi i prillit  
7 kemi dalë në atë pjesë.

8 Py. Nga cilla pjesë jeni nisë për me shku për në Surdull?

9 Pë. Prej fshatit Katunishtë e kemi kalue në pjesën  
10 verilindore të Gollakut.

11 Py. Mbasi që ju bartën nga fusha e betejës, e luftës për  
12 fshatin Turiqicë, shërimin e juaj a e kanë kry aty në atë  
13 fshat?

14 Pë. Jo, sepse s'ka pasë kushte aty as minimale. Ka qenë një  
15 shtëpi e improvizuar. Vetëm ndihma e parë më është dhënë.

16 Py. Në qatë vend ku keni qenë ju si i plagosur, a kanë sjellë  
17 edhe ushtarë të tjerë aty? A ka pasë edhe ushtarë tjerë të  
18 plagosur?

19 Pë. Më falni, jo si i plagosur, por i plagosur.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

21 Dëshmitar, prit pak para se të përgjigjes, të lutem. Edhe  
22 njëherë, ju lutem përgjigjuni edhe njëherë.

23 Z. SHALA:

24 Py. Po z. Dëshmitar, i plagosur.

25 Pë. Jo, s'i i plagosur, por i plagosur kam qenë.

1 Py. Po, i plagosur.

2 Pë. Nuk e kam parë. Nuk e di sepse unë kam qenë në gjendje  
3 pak ma të rëndë. Ka pasë civilë, disa fëmijë, ka pasë të  
4 plagosur por ushtarë nuk e di. S'kam pa.

5 Py. Dhe ju kanë bartë nga Turiqica në ndonjë vend tjetër ku  
6 do të kishte kushte më të mira për shërimin e juaj?

7 Pë. Po. Prej aty e kemi pasë spitalin e improvizuar në  
8 fshatin Potok, në veriperëndim, krejt në anën e kundërt të  
9 asajna.

10 Py. E thatë në anë e kundërt. Përafërsisht a e dini sa larg  
11 është fshati Turiqicë me fshatin Potok?

12 Pë. Nuk mund ta di, por vetëm e di që e kemi bërë dy ditë. Ma  
13 shumë se 48 orë për me arrit në spitalin e improvizuar në  
14 fshatin Potok.

15 Py. A ju kujtohet cillat fshatra krejt i keni kalu në atë  
16 kohë?

17 Pë. Fshatrat më kujtohen kur kemi kalue para se mu u plagos.  
18 Por mbasi që jam plagos, jo, nuk më kujtohet, sepse nuk kam  
19 mujtë me i përcjellë se gjendja jeme shëndetësore s'më ka  
20 lejuar.

21 Py. A ju kujtohet në cillën ditë ju kanë mbartë në fshatin  
22 Potok?

23 Pë. Ju lutem, a ka mundësi specifikisht? Specifikona. A po  
24 mendon atë ditë, a kur kemi mbërri në fshatin Potok, a si?

25 Py. Pasi që jeni plagosur. Nga fushëbeteja ju kanë mbartë në

1 shatin Turiqicë.

2 Pë. Po.

3 Py. Edhe thatë që plagosja juaj ka ndodhë më datë 10 prill të  
4 vitit 1999. Sa keni ndejtë në Turiqicë a ju kujtohet?

5 Pë. Nuk e di, të them të drejtën. Po e themi kushtimisht,  
6 katër, pesë orë sa më është dhënë ndihma e parë edhe deri sa  
7 janë përgatitë që e kanë gjetë një traktor me rimorkio. Edhe  
8 kur ka ra muzgu, më kanë qitë në atë rimorkio edhe kemi fillu  
9 për me shkue te spitali ushtarak që ka ekzistue në Potok.

10 Py. Do të thotë të njëjtën ditë që jeni plagosur edhe është  
11 ndërmarrë veprimi i bartjes suaj për në fshatin Potok?

12 Pë. Po.

13 Py. A e dini kush e ka organizu transportin e juaj nga fshati  
14 Turiqicë deri në fshatin Potok?

15 Pë. Sigurisht, Cali. Edhe ka bë edhe sigurimin e rrugës.

16 Py. Pse po thuani Cali?

17 Pë. Sepse logjika më çon aty, se ka qenë përgjegjës për atë  
18 pjesë, për kalimin e njerëzve, ushtarëve, të mirat materiale,  
19 furnizimin. Sepse e ka furnizue gjithë atë popullatë. Kanë  
20 qenë mbi 40.000 mijë të zhvendosun dhe të vendosun në atë  
21 pjesë aty. Kështu që mendja ma merr, se unë s'kam mujtë me e  
22 perceptu edhe me ditë saktësisht se kam qenë vetë në gjendje  
23 të rëndë.

24 Py. Kur thua "Cali", apo mendon për Salih Mustafën?

25 Pë. Po. Çdo herë i referohem Salih Mustafës.



1 Py. Po gjatë asaj periudhe kohore sa ka zgjatë transporti nga  
2 Turiqica deri te fshati Potok, a e keni pa ju personalisht  
3 Salih Mustafën?

4 Pë. Po.

5 Py. A ju kujtohet si ka qenë ai? Si e keni pa? A e keni pa  
6 duke lëvizë apo ka kontaktu me ju?

7 Pë. Unë thashë ka bë sigurimin e rrugës sepse kanë qenë në  
8 rrugë gjarpërore, rrugë dytësore të maleve. Por në dy raste  
9 është ndalë traktori me rimorkim me pushu, se ka qenë një kohë  
10 jashtëzakonisht e keqe me t'reshma atmosferike të mëdhaja. Ka  
11 qenë një ftoftë. Dhe është ardhë, është afër, më ka pyet "Si  
12 je?" dhe "A po mundesh me qëndru?" Edhe kaq.

13 Py. E përmendni traktorin me rimorkio. A keni qenë vetëm ju  
14 në atë rimorkio i vendosur?

15 Pë. Jo, kemi qenë së bashku me komandantë Lekën. Nuredin  
16 Ibishin.

17 Py. A ju kujtohet përveç Calit, a keni pa edhe ushtarë tjerë?

18 Pë. Kjo është në mënyrë hipotetike "A keni pa?". Ka mujtë me  
19 pa po s'kam mujtë me i identifiku kush është se ka qenë terr,  
20 natën, shi. Dhe, sigurisht, ka pasë ata që i kanë ndihmue, se  
21 ai veç vetëm, as Salih Mustafa as kërrkush s'mund të bëjë  
22 asgjë.

23 Py. Po pyetja ime është, a ka pasë edhe ushtarë tjerë, jo a i  
24 keni njoftë ata.

25 Pë. Sigurisht, që po.

1 Py. Rruga nga fshati Turiqicë deri në Potok, a e dini a e ka  
2 -- gjatë tërë rrugës ju ka përcjellë Salih Mustafa me ata  
3 ushtarët tjerë?

4 Pë. Pjesën dërrmuese po, ma tepër se gjysëm, gjysmën e rrugës  
5 apo të themi gjysën e rrugës te do fshatra. Nëse s'gaboju.  
6 Sepse mu përkeqësu gjendja tej mase edhe më kanë zbrit në një  
7 fshat, nuk e -- s'jam i sigurtë a ka qenë Bellopoja, a ka qenë  
8 Rimanishta. Edhe kemi pushu aty disa orë. Edhe, sigurisht, tej  
9 aty Cali ka pasë për detyrë dhe obligim, ka pasë detyra tjera  
10 dhe është kthye. Aty anej ka marrë personat e Brigadës 151  
11 edhe na kanë transportue për Potok.

12 Py. Kur keni mbërri në Potok, a keni mbërri me vetëdije, keni  
13 qenë me vetëdije?

14 Pë. Mund të them pjesërisht. Ka pasë kohë më ka ardhë  
15 vetëdija. Po ka pasë raste edhe që e kam humbë vetëdijen.

16 Py. A ju kujtohet sa ka zgjatë shërimi juaj? Sa keni qëndruar  
17 ju në spitalin e improvizuar në Potok?

18 Pë. Dikun deri ka fundi i prillit 1999.

19 Py. Pas kësaj ku keni shkuar?

20 Pë. Pas kësaj jemi zhvendosë sepse kanë qenë luftime dhe  
21 granatime të përditshme. Prej 24 dhjetorit 1998, beteja e  
22 Llapashticës dhe asnjë ditë nuk ka qenë pa luftime. Qoftë të  
23 intensitetit herë ma të lartë edhe herë ma të ultë, po  
24 megjithatë, çdo ditë ka pasë luftime. Dhe jemi zhvendosë në  
25 fshatin Popovë. Prej aty është organizue edhe na kanë bartë na

1 kanë çue në pjesën e Rimanishtes edhe Zllash. Sepse qëllimi i  
2 shkuarjes në Zllash ka qenë depërtimi për me më dërgue në  
3 Maqedoni, në Tetovë konkretisht, për shërim të mëtutjeshëm.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
5 vazhdoni, Avokati Mbrojtës.

6 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

7 Z. SHALA:

8 Py. Z. Dëshmitar, gjatë kohës sa keni qenë në Potok, a e keni  
9 taku aty Salih Mustafën?

10 Pë. Me sa më kujtohet mua, jo.

11 Py. A ju kujtohet, kur keni qenë, pasi që keni lëshu Potokun,  
12 në Zllash? Në cillën periudhë kohore keni qenë në Zllash?

13 Pë. Sigurisht ka qenë -- sepse kanë qenë dy tentime për  
14 daljen në Maqedoni. E para ka qenë e pamundshme. Jemi kthyer.  
15 Mund të them dikun fundi i prillit. Datën e saktë nuk e di, po  
16 fundi i prillit, fillimi i majit. Nuk e di. S'jam i sigurtë  
17 saktë, por aty dikund duhet të jetë.

18 Py. Thatë janë ndërmarrë dy tentime për me dalë në Maqedoni.  
19 Herën e parë nuk ka pasë sukses. Këtë periudhë kohore që po e  
20 cekni që keni qenë në Zllash, fundi i prillit apo fillimi i  
21 majit, a e nënkupton për herën e parë apo për herën e dytë?

22 Pë. Po mendon mbas plagosjes apo në tërësi?

23 Pë. Mbas plagosjes.

24 Pë. Mbas plagosjes, hera e parë.

25 Py. Herën e dytë --

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'e  
2 kuptoj mirë cila që -- s'kuptoj as pyetjen, as përgjigjen, për  
3 të qenë e singertë. Thatë që ishte --

4 Ju lutem mund të hiqni pak dëgjueset, z. Dëshmitar.

5 "Thatë se u bënë dy orvatje për t'ju çuar në Maqedoni.  
6 Herën e parë nuk ja dolët mbanë. Gjatë kësaj periudhe kohore  
7 që ishit në Zllash..."

8 Cila ishte pyetja atëherë? "Do të thuash gjatë orvatjes  
9 së parë apo orvatjes së dytë?" Çfarë -- cila është pyetja  
10 juaj?

11 Z. SHALA: [Përkthim] Në fund të prillit, fillimi i majit  
12 ishte në Zllash. Pas kësaj tha u bënë dy orvatje. Një orvatje  
13 për Maqedoni nuk ja doli me sukses dhe një përpjekje tjetër.  
14 Pyetja ishte: A ishte atje herën e parë apo --

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Shiko. S'i e kuptova unë ishte, në periudhën kohore që  
17 dëshmitari ishte në Zllash, u bënë dy përpjekje dy orvatje për  
18 ta çuar në Maqedoni.

19 Pra, ai ju përgjigj pyetjes suaj në harkun kohor, fundi i  
20 marsit, fillimi i majit, pra, në këtë periudhë kohore u bënë  
21 dy orvatje për ta çuar në Maqedoni. Dhe orvatja dy doli me  
22 sukses, se ma sa duket arriti të shkonte në Maqedoni.

23 Pra, nuk ishte diku tjetër. Në Zllash ishte, kështu e  
24 kuptova unë dhe u bënë dy orvatje. Nëse ju nuk jeni i sigurtë,  
25 mund ta konfirmoni. Pyesnin dëshmitarin ta konfirmojë këtë

1 gjë. Po mendoj se këtë tha.

2 Z. SHALA: [Përkthim] Në rregull. S'isha i sigurtë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
4 po. Mos ja dikto përgjigjen. Pra, pati dy orvatje për ta çuar  
5 në Maqedoni, mund t'i thuash, ku ishit ju gjatë kësaj kohe?  
6 Dhe kështu ai mbase dhe i përgjigjet pyetjes.

7 Z. SHALA:

8 Py. Z. Dëshmitar.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Doni  
10 të bëni ndonjë pyetje, z. Dëshmitar?

11 DËSHMITARI: Jo. Një minutë po e kërkoj vetëm pauzë. Vetëm  
12 një minutë, sa të ndreqna pak.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një  
14 minutë. Do të dalësh?

15 DËSHMITARI: Jo. Këtu, këtu. Veç të ndreqem pak.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
17 Patjetër. Patjetër. Vazhdoni. Faleminderit.

18 Z. Dëshmitar, mjaftoi?

19 DËSHMITARI: Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
21 qoftë se ke nevojë për më shumë kohë na thuaj lirisht.

22 DËSHMITARI: Jo, në rregull është. Në rregull. Mund të  
23 vazhdojmë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,  
25 atëherë.

1 Avokat Mbrojtës, atëherë vazhdoni.

2 Z. SHALA:

3 Py. Z. Dëshmitar, thatë që fundi i muajit prill të vitit 1999  
4 apo fillimi i po të njëjtit vit, keni qenë në Zllash me qëllim  
5 të ndërmarrjes së rrugës për në Maqedoni. Dhe thatë që i keni  
6 pasë dy tentime. A keni qenë në Zllash në të dyja ato tentimet  
7 që i keni ndërmarrë në qatë periudhë kohore?

8 Pë. Në fakt, i kam ndërmarrë sepse unë kam qenë i pafuqishëm.  
9 Por po dy herë kam qenë, kam nejtë në Zllash.

10 Py. Më intereson ta sqaroj. Herën e parë, kur është tentu  
11 hera e parë? Kur ka qenë hera e parë që është tentu?

12 Pë. Fundi i prillit, fillimi i majit dikun.

13 Py. Hera e dytë kur është tentu?

14 Pë. Dikun ka -- duhet të jetë gati fundi i majit.

15 Py. Dhe gjatë kësaj periudhe kohore prej tentimit të parë  
16 deri në tentimin e dytë, a keni qenë tanë kohën në Zllash?

17 Pë. Jo.

18 Py. Pas tentimit të parë, pas sa ditësh keni shku nga  
19 Zllashi?

20 Pë. Sa kanë mujtë me qenë tri-katër ditë. Eventualisht katër  
21 ditë po e them. Pesë maksimumi.

22 Py. Në fund të prillit dhe fillim të majit të vitit 1999, kur  
23 keni shku në Zllash, me qëllim që t'ju transpotojnë për  
24 Maqedoni, a e keni taku Salih Mustafën aty?

25 Pë. Po, e kam pa kalimthit.

1 Py. A ju kujtohet --

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat i Mbrojtjes, më falni pak.

4 Z. Dëshmitar, hiqni pak dëgjueset ju lutem.

5 Kemi folur shumë për Zllashin. Kemi kohë që flasim për  
6 Zllashin, mendoj se do ishte më mirë sikur të eksploroni më  
7 shumë ku në Zllash, sepse më përpara u përpoqët por pastaj  
8 devijuat sikur donit të flisnit për një temë, për një aspekt  
9 tjetër. Po të jemi më pak specifik, sepse kemi diskutuar goxha  
10 për këtë pikë.

11 Z. SHALA:

12 Py. A ju kujtohet, z. Dëshmitar, a ju kujtohet herën e parë  
13 kur keni qenë në Zllash, fundi i muajit prill dhe fillimi i  
14 muajit maj i vitit 1999, kur them "herën e parë" e lidhi me  
15 tentimin për me shku në Maqedoni. A ju kujtohet ku keni qenë i  
16 vendosur?

17 Pë. Po, më kujtohet.

18 Py. A mund të na tregoni ku?

19 Pë. Në një shpi private e improvizuar. S'po di ç'a t'i them.  
20 Lloj ambulante, lloj, po e quajmë kushtimisht spital. Sepse  
21 s'ka qenë spital, por i asaj natyrës sa me pushu edhe me mujt  
22 me marrë shërbimet ato elementaret infusion, ndonjë injeksion,  
23 këto kështu.

24 Py. A ju kujtohet kur keni hy në atë shtëpi? Pamja e asaj  
25 shtëpie.

1 Pë. Jo, s'mund me e përshkruaj sepse ka qenë orët e vona dhe  
2 them sinqerisht - më fal - nuk kam mujtë unë me i çu kryet se  
3 më dashtë të gërmyst me hy për shkak të plagëve që i kisha dhe  
4 nuk e di. Po e di që ka qenë shpi fshati përdhese.

5 Py. A ju kujtohet sa dhoma kanë qenë aty?

6 Pë. Jo, nuk e di sa dhoma se s'kam qenë -- unë s'kam mujtë me  
7 dalë me i vizitu ato sa. Unë, më kanë vendosë në qatë dhomë,  
8 kanë qenë dy kreveta.

9 Py. Kur keni dalë prej asaj shtëpie, përkatësisht kur ka  
10 qenë, mbas sa dite ka qenë tentimi për me marrë rrugën për në  
11 Maqedoni?

12 Pë. Po mendon për herën e parë?

13 Py. Herën e parë.

14 Pë. Herën e parë një ditë e gjysë. Një natë kam fjetë aty.  
15 Dhe të nesërmen, tej ka mesi i ditës, na e kanë organizue  
16 ekipa e Salih Mustafës, në krye me Saliun edhe kemi arrit në  
17 do fshatra deri afër brezit kufitar me Serbinë. Dhe aty jemi  
18 informue që serbët sigurisht kanë pasë informacioni dhe kanë  
19 rrethue disa fshatra. Na është dashtë me u kthye prapë. Edhe  
20 një natë në kthim e sipër kam bujtë aty. Domethënë edhe kemi  
21 kalu në Keçekollë tash, në Koliq në fakt. Sa ka qenë ajo dy,  
22 tre ditë krejt rrugë po mendoj, katër ditë, pesë maksimumi.

23 Py. Në momentin kur keni dalë nga ajo shtëpi, a keni pasë  
24 mundësi me pa përreth asaj shtëpie çka ka, ambientin e  
25 jashtëm?



1 Pë. Po sikur të isha në situatë sikur sot, po. Nën situatën  
2 në çfarë e kam qenë unë, jo.

3 Py. Po prandaj pyetja ime ishte a keni pasë mundësi?

4 Pë. Jo, jo s'kam pasë mundësi. Sepse unë kam qenë ma tepër i  
5 shtirë. E kam pa vetëm qiellin.

6 Py. E njëjta gjendje edhe kur jeni kthy?

7 Pë. Fatkeqësisht, po.

8 Py. Herën e dytë, a mund të na tregoni edhe njëherë,  
9 për afërsisht, cillën periudhë kohore keni tentu -- keni shku  
10 në Zllash për me ndërmarrë veprimin e transportimit për në  
11 Maqedoni?

12 Pë. Pjesa e dytë ka -- po e them në mënyrë hipotetike, sepse  
13 është e pamund, datat nuk i mbaj mend. Nuk i di. Po ka qenë,  
14 po e themi 20 maji, ka mujtë me qenë 15 maji, aty dikund dhe  
15 tentimin e dytë ja kemi dalë. E, sigurisht, ka qenë organizimi  
16 dhe përpjekjet ma të mira edhe na ka përcjellë Salih Mustafa  
17 deri në fshatin Bullaj. Sepse prej Zllashit nëpër Mramor e  
18 kalon bien te Bullajt. Deri atje na ka përcjellë personalisht.  
19 Aty i ka ngarkue disa ushtarë, djem të atij rrethi që e kanë  
20 njohë zonën edhe kemi vazhduar.

21 Py. Herën e dytë, a ju kujtohet sa keni ndejtë në Zllash para  
22 se të ndërmerrni rrugën për në Maqedoni?

23 Pë. Nuk e di. S'më kujtohet. S'mund të them që kaq, sepse po  
24 ta kisha ditë që kam ardhë me dëshmue e kisha mbajtë në  
25 shënim. Po nuk e di. Tri, katër por them dy ditë, tri. Nuk e

1 di. S'jam i sigurtë.

2 Py. Natyrisht.

3 Pë. Sepse për mu një ditë ka qenë një javë, për mue  
4 personalisht. Tash gjithçka ça të them është e tepërt. Është e  
5 pabesueshme për pjesën dërrmuese të juajën, por mue kështu  
6 është e vërteta.

7 Py. Herën e dytë kur keni shku për ndërmarrë rrugën për  
8 Maqedoni, a ju kujtohet shtëpia ku keni ndenjtë?

9 Pë. Ju lutem ma specifik, ma konkret bëne? Po mendon në  
10 Zllash apo gjatë rrugëtimit ka kemi lëvizë?

11 Py. Jo, në Zllash. Herën e dytë kur ke shku në Zllash?

12 Pë. Ka qenë e njëjta shtëpi.

13 Py. A ke pasë mundësi kësaj radhe me pa pamjen e jashtme të  
14 shtëpisë?

15 Pë. Fatkeqësisht, jo. Unë jua thashë. nuk e di sa po jam i  
16 kjartë. Por unë pa ndihmën e shokëve që më kanë mbart, unë  
17 s'kam mujtë me lëvizë. Dhe s'jam kanë në gjendje unë me e çue  
18 kokën lartë me pa ose anash. Mu kanë mbartë thjesht në lesër  
19 më kanë mbajtë, si kufomën. Njëri i gjallë, i vdekur.

20 Py. Faleminderit, z. Dëshmitar.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po i  
22 afrohem orës 11.00, nëse mund të mbaroni me pyetjet për këtë  
23 seancë, ju lutem.

24 Z. SHALA: [Përkthim] Po mund të mbarojmë, sepse pas kësaj  
25 pyetjes nuk kam tjetër. Pas konsultimit me ekipin do të shohim

1 çfarë kemi tjetër.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Na  
3 jep një parashikim edhe sa kohë do ju duhet pas pushimit?

4 Z. SHALA: [Përkthim] 10, 15 minuta.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
6 mirë.

7 z. Parduzi, do bëjmë një pushim pas një gjysëm ore dhe  
8 pastaj do thërrasim që të vazhdoni me dëshminë edhe me pyetjet  
9 nga Avokatët Mbrojtës.

10 Faleminderit, z. Parduzi.

11 DËSHMITARI: Faleminderit juve.

12 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit.

15 Znj. Prokurore, pas pushimit mesa duket kemi një çerek të  
16 mbetur. Vetë ZPS-ja çfarë parapëlqen, të bëjë pushim apo të  
17 vazhdojmë me kundrapyetjet?

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Si të dëshironi ju, e nderuar  
19 Gjykatëse. Mund të shfrytëzoj pushimin tani për t'u  
20 përgatitur. Po ka shumë fusha që duam të shfrytëzojmë nga  
21 dëshmia e sotme dhe deklaratat dhe nga ato që ka përmendur.  
22 Thjesht duhet ta organizojmë pak linjën e pyetjeve. Nëse  
23 dëshironi ju, unë e bëj gjatë pushimit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit. Mund të shtojmë çerek ore pushim, pra, që të mos

1 bëjmë menjëherë pushimin pas këtij pushimit. Prandaj nëse e  
2 bëjmë treçerek ore pushimin, a mund t'ju mjaftonte ju atëherë  
3 mund të mjaftonte ju atëherë për të përgatitur pyetjet?

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, po sugjerim i shkëlqyer  
5 është ky.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Atëherë kështu do të bëjmë.

8 Znj. Sekretare e Gjykatës, a mund ta informoni  
9 dëshmitarin që do të zgjasë pushimi dhe një çerek ore më  
10 shumë.

11 Atëherë, shumë mirë. Do të mblidhemi në 11.45 do të  
12 rifillojmë.

13 Seanca ndërpritet këtu.

14 --- Pauza fillon në orën 10.59

15 --- Seanca rifillon në orën 11.45

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
17 Shohim që të jemi këtu të gjithë siç ishim edhe përpara se të  
18 merrnim pushimin.

19 Znj. Sekretare, ju lutem të sillni dëshmitarin në sallë.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
22 se vini edhe një herë z. Parduzi.

23 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
25 dëgjoni?

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Ia jap fjalën Avokatit Mbrojtës për të vazhduar pyetjet e  
5 tij.

6 Ju e keni fjalën z. Avokat.

7 Z. SHALA: [Përkthim] Faleminderit e nderuar Gjykatëse.

8 Py. Z. Dëshmitar, a të kujtohet në kohën kur nga fshati  
9 Turuçicë është organizuar transporti yt për në fshatin Potok?  
10 A ka qenë rruga e vështirë dhe çfarë kohe ka qenë në atë  
11 periudhe? Çfarë kohe po mendoj në kushte klimatike.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Prisni. Janë tre pyetje të ndryshme, sipas mendimit tim. A  
14 ishte e vështirë rruga, si ishte moti, koha e kështu me radhë.  
15 Janë disa pyetje, janë 2 pyetje. Ndoshta mund t'i merrni --.

16 Z. SHALA: [Përkthim] Ndoshta është gabim përkthimi. Nuk  
17 ishte çështje kohe, por ishte çështje e motit. Po e përsëris  
18 edhe një herë, e kam fjalën thjeshtë për kushtet e rrugës dhe  
19 kushtet e motit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
21 është e qartë. Faleminderit.

22 DËSHMITARI: Po, më kujtohet.

23 Z. SHALA: [Përkthim]

24 Py. A mund të na i tregoni, të na i përshkruani?

25 Pë. Po mendoni rrugën apo motin, kohën?

1 Py. Së pari për kushtet e rrugës.

2 Pë. Kushtet atmosferike kanë qenë jashtëzakonisht të rënda  
3 dhe tërë kohën ka ranë shi. Shi pa ndërprerje dhe ka qenë një  
4 i ftohtë, mund të them -- nuk e di sa ka qenë minus, apo. Por  
5 ka qenë bukur ftohtë.

6 A mund pyetjen e dytë?

7 Py. Kushtet e rrugës?

8 Pë. Tmerrësisht kanë qenë të vështira. Rrugë malore, tejet të  
9 rënda.

10 Py. Ju gjatë dëshmisë suaj sot thatë që në fshatin Rimanishtë  
11 jeni ndalur për të pushuar. A të kujtohet sa ka zgjatë rruga  
12 prej fshatit Turuçicë deri në Rimanishtë?

13 Pë. Unë e thashë, nuk jam i sigurt, a në Rimanishtë, a në  
14 Bellopojë. Në njërën prej këtyre të dyjave. Por në cilën, e  
15 thashë edhe ma lart, nuk e di në cilën. Nuk e di sa ka zgjatur  
16 sepse unë kam qenë në gjendje të rëndë. Por e di që diku kemi  
17 rrugëtuar gjithë natën, të nesërmen gjithë ditën. Nga mbrëmja  
18 kemi mbërrit në fshatin, tash a ka qenë Rimanishtë, apo ka  
19 qenë Bellopojë, nuk jam i sigurt.

20 Py. Dhe gjatë asaj dite për herë të fundit Salih Mustafën e  
21 keni parë në fshatin ose Bellopojë, ose Rimanishtë, në cilin  
22 do që jeni ndalë për të pushuar?

23 Pë. Po.

24 Py. Faleminderit.

25 Z. SHALA: [Përkthim] Vetëm një sekondë, e nderuar

1 Gjykatëse, që të konsultoj bashkëavokatin tim.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni, z. Avokat.

4 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

5 Z. SHALA: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk kemi pyetje  
6 të tjera. Faleminderit.

7 Py. Z. Dëshmitar, Mbrojtja nuk ka më pyetje. Faleminderit  
8 shumë.

9 Pë. Faleminderit juve.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit z. Avokat i Mbrojtjes.

12 Përpara se t'ja jap fjalën ZPS-së për të bërë  
13 kundërpyetjet e tij, Trupi Gjykses do të nxjerrë një urdhër  
14 gojor lidhur me materialet që do të shfrytëzojë gjatë pyetjeve  
15 ZPS-ja.

16 ZPS-ja ka kërkuar leje nga Trupi Gjykses, me anë të një  
17 emaili të 8 prillit 2022 të orës 11.16, për të shfrytëzuar dy  
18 materiale të reja të nxjerra së fundmi për seancën e kundër  
19 pyetjeve të Dëshmitarit të Mbrojtjes 900. Materiali është  
20 nxjerrë menjëherë në orën 11.22.

21 Trupi Gjykses vëren se materialet e nxjerra janë gjetur  
22 nga ZPS-ja në ditët e fundit gjatë përgatitjes për seancën e  
23 kundërpyetjeve të dëshmitarit. Trupi Gjykses konstaton se  
24 materiali nuk është i gjatë dhe se Avokatët Mbrojtës dhe  
25 Mbrojtësi i Viktimave kanë pasur kohën e mjaftueshme për ta

1 studiuar atë.

2 Për më tepër Mbrojtja nuk e kundërshton këtë.

3 Dhe për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka  
4 treguar se ekzistojnë arsye të qëndrueshme për të mos i  
5 nxjerrë materialet e mëparshme dhe autorizon ZPS-në që ta  
6 shfrytëzojë atë gjatë seancës së kundërpjetjeve për  
7 Dëshmitarin 900, në përputhje me paragrafin 31 të Vendimit të  
8 Procedurave.

9 Këtu përfundon urdhri i Trupit Gjykses.

10 Znj. Prokurore tani mund të vazhdoni me kundërpjetjet  
11 tuaja.

12 Ju e keni fjalën znj. Prokurore.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
14 Gjykatëse. Sa për të treguar mbi shfrytëzimin e kohës, do të  
15 vazhdoj deri në orën 13.00.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
17 këtë koment desha ta bëja. Ne duam të vazhdojmë deri në orën  
18 13.15 që të shfrytëzojmë të tërë periudhën prej një ore e  
19 gjysmë që kemi në dispozicion. Dhe për sa i përket mbas ditës,  
20 do të flasim me Njësinë Administrative për mënyrën se si do të  
21 procedojmë.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
23 Gjykatëse.

24 Pyetje të palës tjetër nga Znj. D'Ascoli:  
25 Py. Z. Parduzy, mirëdita. Unë jam Avokatja e Prokurorisë. Do



1 t'ju bëj pyetje gjatë ditës së sotme dhe përpara se të  
2 fillojmë, po ju kujtoj njësoj siç tha edhe Kryegjykatësja, që  
3 të lejoni një kohë mes pyetjes dhe përgjigjes. Të dëgjoni në  
4 fillim përkthimin dhe pastaj të përgjigjeni. Dhe po kështu që  
5 të përqendrohni në pyetjet që bëj unë me qëllim që t'iu  
6 përgjigjeni pyetjeve specifike, pa dhënë hollësi të mëtejshme.  
7 Nëse ka nevojë për hollësi, unë do t'ju kërkoj që t'i jepni  
8 këto hollësi. A më kuptoni?  
9 Pë. Po, kuptoj.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit. Ju e ngritët dorën.

12 Znj. Prokurore, do t'ia jap fjalën dëshmitarit.

13 Z. Parduzi, çfarë deshët të thonit?

14 DËSHMITARI: Sigurisht në përkthim është bërë gabim. A  
15 është Prokurore apo është Avokate e Prokurorisë. Sepse  
16 interpretimi në shqip më erdhi si Avokate.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo  
18 është Prokuroria dhe është përfaqësuese e Prokurorit të  
19 Specializuar. Pra, është anëtare e ekipit të Prokurorisë, të  
20 cilët ne i quajmë Avokat i Prokurorisë. Ndoshta kjo ju ka  
21 shkaktuar këtë hutim. Por është juriste e Prokurorisë.

22 DËSHMITARI: Desha ta sqarojmë, se jo hutim.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

24 Py. Z. Parduzi, kam disa pyetje për të sqaruar ato që keni  
25 thënë, së pari periudhës së vitit 1998, për kohën kur keni

1 shkuar në Zllash dhe keni takuar z. Salih Mustafa.

2 Ju thatë sot që e keni takuar dy herë z. Salih Mustafa  
3 gjatë vitit 1998. Herën e parë thatë që mund të kishit qenë  
4 rreth korrikut të 1998, është në faqen 16, rreshti 9 të  
5 transkriptit, dhe thatë që kjo ka gjasa të ketë ndodhur në  
6 Bajgorë, dhe kjo ndodhet në faqen 15, rreshti 16. A ju  
7 kujtohet që e thatë këtë?

8 Pë. Po, më kujtohet edhe ashtu është.

9 Py. Dakord. Më pas thatë që herën e dytë kur e keni takuar z.  
10 Mustafa, kjo ka ndodhur kur shkuat në Zllash për të dërguar  
11 armë dhe municione në tetor të '98-s. Dhe kjo ishte në faqen  
12 20, rreshtat 13 deri në 14. A ju kujtohet?

13 Pë. Po, më kujtohet. Por mos e keqinterpretoni se pak më  
14 ndryshe e thashë më herët.

15 Py. Si e thatë? Pasi unë u tregova shumë e kujdesshme duke  
16 citur transkriptin e seancës së mëngjesit. Çfarë mendoi që  
17 është e ndryshme nga ajo që thashë unë?

18 Pë. Jo, nuk po mendoj, por po e them që po, e kam takuar  
19 thashë kur i kam dërguar disa armë e municion, e kam parë  
20 vizualisht aty, por shumë shkurt. Kjo është përgjigja në  
21 pyetjen e Avokatit.

22 Py. Pikërisht këtë përmenda dhe unë. Megjithatë, do të bëj  
23 disa pyetje të tjera lidhur me këtë takim. Kështu që në qoftë  
24 se do të keni gjë për të shtuar, do t'jua jap mundësinë për ta  
25 bërë këtë.

1 Së pari, dua të sqaroj pasi duket sikur në tetor të '99-s  
2 ju vetë shkuat në Zllash. Kështu është? Ju kërkoj ndjesë,  
3 është '98.

4 Pë. Kam shkuar me një vozitës, jo vetëm.

5 Py. Dakord. Kur i dhatë dëshminë tuaj palës Mbrojtëse në  
6 shkurt 2001, a keni pasur mundësinë që ta rishikonit edhe një  
7 herë këtë deklaratë?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e nderuar  
9 Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
11 Dëshmitar, ju lutem hiqini dëgjueset. Faleminderit.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë besoj që është praktikë e  
13 njohur këtu që kur vinë dëshmitarët këtu për të dhënë dëshminë  
14 gojore, ato e analizojnë apo rishikojnë dëshmitë e tyre. Në  
15 qoftë se Prokuroria po pyet për ndonjë gjë tjetër, dakord.  
16 Por, praktika është e njohur që dëshmitarët që vijnë këtu e  
17 rishikojnë deklaratën e tyre. Prandaj unë po pyes nëse po  
18 flitet për një rast tjetër apo për momentin e tanishëm?

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, pyetja  
20 ishte specifike nëse deklaratën e ka parë, e ka lexuar në  
21 shqip në periudhën kur e ka dhënë dëshminë në shkurt të vitit  
22 2021.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
24 kështu e kuptova edhe unë. Dhe kjo pyetje është bërë edhe në  
25 raste të tjera.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Po mendoja nëse ishim vërtetë  
2 duke iu referuar kësaj periudhe.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e  
4 kemi të qartë këtë tashmë?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Dëshmitar, vendosini dëgjueset.

8 Znj. Prokurore ju e keni fjalën.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.  
10 Py. Z. Parduzy, po i kthehem edhe njëherë pyetjes që bëra që  
11 të mund të më jepni përgjigje. Pyetja ishte: Nëse më datën 26  
12 shkurt 2021, pas përfundimit të dhënies së dëshmisë suaj për  
13 Mbrojtjen, keni pasur mundësinë për ta lexuar apo analizuar  
14 këtë deklaratë që keni dhënë?

15 Pë. Po, sigurisht mbas dhënies së saj, e ka lexuar. Edhe e  
16 kam nënshkruar.

17 Py. Dhe kam vërejtur që ju i keni vënë inicialet në secilën  
18 faqe dhe keni vënë firmën në faqen e fundit. Ju kujtohet kjo,  
19 apo jo?

20 Pë. Po, po, gjithsesi.

21 Py. Dhe a ishit i bindur që përgjigjet që keni dhënë, kanë  
22 qenë përgjigjet e përshtatshme, me sa ju kujtohet në atë  
23 moment?

24 Pë. Unë nuk e di, nuk e vlerësoj a kanë qenë të përshtatshme  
25 apo s'kanë qenë të përshtatshme. S'ka qenë punë dëshirash.

1 Pyetjet që mu kanë shtruar, unë jam përgjigj. Edhe qëndroj  
2 mbrapa atyre përgjigjeve që i kam dhënë.  
3 Py. Dakord. Dua të shohim disa ndryshime mes përgjigjeve që  
4 keni dhënë sot dhe përgjigjeve të atëhershme, për të kuptuar  
5 se cilat janë arsyet.

6 Për sa i përket vizitës suaj në Zllash në tetor 1998, siç  
7 mësuam sot. Me sa kuptoj, ti vetë shkove në Zllash, apo jo?

8 Pë. Po sigurisht unë vetë. Unë e thashë vetë që askush tjetër  
9 jo.

10 Py. Po e bëja pyetjen pasi që kur lexova deklaratën tuaj të  
11 shkurtit 2021, nuk ishte e qartë që ti vetë kishe shkuar në  
12 Zllash. Dhe atë e lexova në faqen 4.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Numri rendor është 00036-00048.

14 Py. Dhe fjalia që po lexoj është që kur ju po përmendnit  
15 Zllashin thatë që:

16 "Në një periudhë të caktuar kohore të vitit 1998, nuk ju  
17 kujtohet se kur, por di diku nga shtatori apo tetori 1998, ne  
18 dërguam disa armë atje dhe nga atje morëm disa furnizime  
19 ushqimore".

20 A ju kujtohet kjo gjë e tillë?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
22 Dëshmitar, prisni një çast.

23 Znj. Prokurore, a ka ndonjë arsye se përse nuk po  
24 vendoset ky material në ekran?

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

1 Thjeshtë se ishin vetëm 3 rreshta në këtë fjali.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
3 dëshiroja që ta vendosim në ekran.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po. Atëherë do t'i kërkoj  
5 Sekretarisë që deklaratën e dëshmitarit për Mbrojtjen të 26  
6 shkurtit 2021, ta vendosin në ekran.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
8 kështu dhe pala e Mbrojtjes të ketë mundësinë që ta analizojë  
9 këtë pjesë.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
11 Gjykatëse. Po lexoja nga fundi i faqes 4.  
12 Py. Pra, pyetja që kisha unë z. Dëshmitar, ishte që ju thatë:

13 "Dërguam disa armë atje dhe morëm disa furnizime  
14 ushqimore".

15 Dhe këtu flitet për Zllashin. A ju kujtohet?

16 Pë. Para se të përgjigjem, ma vendosni në shqip deklaratën,  
17 versionin shqip. Se veç anglisht e kam .

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
19 dëgjoni përkthimin. A doni që t'jua përkthejmë edhe njëherë?

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

21 Py. Edhe origjinali i kësaj deklarate ishte në anglisht. Dhe  
22 besoj që ju është lexuar edhe në shqip. Por mbase nuk e keni  
23 pasur versionin shqip në atë kohë. Z. Dëshmitar, a dëshironi  
24 që t'i lexoj edhe njëherë këto dy fjali që sapo i lexova, për  
25 sa i përket tetorit 1998?

1 Pë. Po, edhe njëherë përsërite këtë pyetje.

2 Py. Dakord. Ju thatë, për sa i përket Zllashit:

3 "Diku në vitin 1998, nuk më kujtohet ekzaktësisht kur,  
4 por diku nga shtatori apo tetori 1998, ne dërguam disa armë  
5 atje dhe morëm disa furnizime ushqimore nga atje".

6 A ju kujtohet?

7 Pë. Po, sigurisht që më kujtohet.

8 Py. Pyetja ime ishte që nga kjo fjali nuk ishte e qartë që ti  
9 vetë kishe shkuar në Zllash, atë që e mësuam sot. A është  
10 kështu, apo jo.

11 Pë. Të jeni më qartë në pyetje. S'po e kuptoj pyetjen.

12 Py. Dakord. Po e riformuloj. Përse nuk e the saktësisht që ti  
13 vetë kishe shkuar në Zllash në atë rast?

14 Pë. Jo, nuk është e vërtetë. Unë e thashë që kam shkuar. E  
15 keni edhe në transkript, e keni edhe në deklaratë që, po, kam  
16 shkuar. E kam pohuar dhe e pohoj me tërë qenien time.

17 Py. Sot gjatë dëshmisë suaj u bë e qartë që kishe shkuar  
18 vetë. Dhe arsyeja se për se po kërkoj sqarim është se, nga  
19 leximi i kësaj deklarate, shprehja "ne dërguam disa armë atje  
20 dhe morëm disa furnizime ushqimore", nuk nënkupton  
21 domosdoshmërisht që ti vetë ke shkuar në Zllash. Dhe nuk kam  
22 parë që të jetë përmendur diku tjetër që ti vetë kishe shkuar  
23 në Zllash. Kështu që pyetja ishte se, përse nuk e kishit  
24 shprehur shprehimisht atëherë kur keni dhënë deklaratën?

25 Pë. Megjithatë unë prapë po përgjigjem, edhe pse e ke marrë

1 përgjigjen. Po më duket nonsens. Unë e kam thënë edhe prapë e  
2 them, "kemi shkuar", domethënë më shumë se një. Është shumë.  
3 Në çfarë kontesti ti e nxjerr edhe e përdor, ajo është  
4 problemi i juaj si ju e perceptoni dhe e lexoni. Por, unë  
5 shumë qartë e kam thënë me zë dhe me figurë që, "po, kemi  
6 shkuar", domethënë shumë. Është më shumë se një individ. Unë  
7 kam qenë vetë i dytë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Faleminderit, z. Dëshmitar. Ju lutem, a mund t'i hiqni  
10 dëgjueset?

11 Është e rëndësishme që të shohim variantin në shqip për  
12 të parë se çfarë shkruhet atje. Për të vërejtur nëse ka pasur  
13 ndonjë gabim përkthimi.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Unë besoj që varianti në shqip  
15 është nxjerrë nga anglishtja. Por do ta vendosim në ekran.  
16 Është DSM00749 deri në 000761. Ndoshta është në faqen 3.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
18 desha të shihja se çfarë shkruhet në shqip atje, që të mos  
19 ketë asnjë lloj konfuzioni lidhur me këtë që po dëgjojmë këtu.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në faqen 3 fillimisht, për të  
21 parë nëse është aty kjo pjesë. Faqen 4. Është nga fundi i  
22 faqes, në mes. Ku fillohet me: "Me Zllashin mua më lidhin".  
23 Dua që ta përkthejnë përkthyesit këtë fjali në shqip.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
25 Përpara se të vazhdojmë, a mundet znj. Prokurore të tregoni



1 saktësisht se ku?

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do të përpiqem. Është ku fillon  
3 "Me Zllashin" deri në fund të atij paragrafi ku përfundon me  
4 fjalën "ushqimore".

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Avokati Mbrojtës? Faleminderit.

7 Z. SHALA: [Përkthim] Është mirë që të mos e fillojmë aty,  
8 por përpara fjalës "me Zllashin". Para asaj pyetje, pasi janë  
9 të dyja të ndërlydhura.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
11 Prokurore, a është problem që ta përfshijmë atë?

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, jo. Leximi i tërë i asaj  
13 pjese ndoshta nxjerr edhe çështjen e marsit 1999 të z. Shala  
14 që përmendet më vonë. Nuk ka asnjë problem, nuk ka asnjë  
15 problem.

16 Z. SHALA: [Përkthim] Kjo është e periudhës 1998. Pyetja:  
17 "A keni qenë ndonjëherë në Zllash?"

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] "Për  
19 çfarë e keni fjalën kur thoni Zllashin"?

20 Dhe kur thuhet:

21 "Zllashi ka të bëjë me dy gjëra që diku nga viti, diku  
22 deri në vitin 1998, nuk e mbaj mend saktësisht, por diku nga  
23 shtatori apo tetori 1998 ne kemi dërguar atje disa armë dhe  
24 kemi marrë disa furnizime ushqimore nga atje".

25 Dhe tani dua të kuptoj nëse pyetja që ka bërë znj.

1 Prokurore, përkon me atë që është shkruar në variantin në  
2 shqip, pas "tetorit 1998" ku thuhet se "kemi dërguar disa armë  
3 dhe kemi marrë disa furnizime ushqimore nga atje".

4 Dua të di nga njësia e përkthimit, nëse mundet, ta  
5 përkthejnë të njëjtën fjali nga varianti në shqip, në  
6 anglisht. A është e mundur ta bëjnë një gjë të tillë?

7 Varianti në shqip është i njëjtë me anglishten dhe kjo  
8 është e rëndësishme. Nuk duam ta hutojmë dëshmitarin duke  
9 citur diçka që nuk është e shkruar aty. Pra, është e  
10 rëndësishme që të mos e hutojmë dëshmitarin duke i dhënë atij  
11 përkthimin e variantin në anglisht. Këtë desha të konfirmoja.

12 Vazhdoni znj. Prokurore.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

14 Py. Z. Dëshmitar, e konfirmuam përmes përkthyesve që varianti  
15 në shqip është identik me anglishten që unë ju lexova. Pra,  
16 pyetja e vetme që kisha ishte, se përse nuk e kishit  
17 specifikuar që ti vetë ke shkruar në Zllash në atë rast kur  
18 keni dërguar armë dhe keni marrë furnizime ushqimore.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Unë besoj që dëshmitari na e ka  
20 dhënë përgjigjen, kështu që të nderuar Gjykatës, nëse jeni të  
21 lumtur, do të vazhdojmë në pikën tjetër.

22 Py. Me përjashtim të rastit nëse ka diçka për të shtuar  
23 dëshmitari.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Dëshmitar, ju lutem hiqini dëgjueset.

1 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë po ngre të njëjtën çështje si  
3 kolegu im që, kjo nuk ishte çështje nëse e ka thënë apo jo.  
4 Por se në pyetjen pararendëse thuhet nëse ai ka qenë në Zllash  
5 apo jo dhe ai tha "po". Dhe kjo është ndërlidhja.

6 Citimi i një paragrafi pa kontekstin e pyetjes  
7 pararendëse e bën që në këtë rast Prokuroria të thotë që ka  
8 mospërputhje. Por, në qoftë se nuk lexohet paragrafi  
9 pararendës, atëherë nuk ekziston edhe konteksti për ta  
10 kuptuar. Kështu që është mirë që të sqarohet që këtë e keni  
11 thënë dhe pastaj të bëhet pyetja tjetër.

12 Ia lë -- mund të bëj ç'të dojë pala tjetër por nuk është  
13 e drejtë që të thuhet që ju keni dërguar disa armatime atje  
14 dhe nuk e keni thënë që keni qenë vetë, e kështu me radhë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju e  
16 keni fjalën znj. Prokurore.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Lidhja midis pyetjes që  
18 përmendi z. von Bone dhe pjesës tjetër të paragrafit, e bën të  
19 qartë që dëshmitari ka shkuar në Zllash. Unë po sqaroja  
20 thjesht këtë çështje për sa i përket vitit 1998, pasi nuk  
21 ishte e qartë. Nuk doja të hidhja poshtë dëshminë e  
22 dëshmitarit, thjesht doja që ta bëja të qartë që ka një  
23 ndryshim. Fjalja e parë thotë që "isha atje duke kaluar  
24 anash", dhe këtë e kam kuptuar që bëhej fjalë në pjesën e dytë  
25 në mars apo në prill. Kaq.

1           Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se kjo do të ishte e  
2 qartë atëherë nuk do të kishte pasur mundësi Prokurorja që ta  
3 bëj këtë pyetje, pasi në qoftë se është e qartë, nuk ka nevojë  
4 për t'u sqaruar. Duke thënë "Përse nuk e keni thënë në atë  
5 kohë në mënyrë shprehimisht që nuk -- pse nuk e thatë  
6 shprehimisht që ju kishit qenë atje", kjo nuk është e drejtë  
7 pasi ai e kishte thënë këtë në paragrafin pararendës.  
8 Sigurisht që të dyja pyetjet janë të lidhura njëra me tjetrën.

9           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
10 lutem, m'u drejtohuni mua kur flisni.

11          Z. VON BONE: [Përkthim] Po, dakord. Po të ishte e qartë,  
12 atëherë nuk do ishte nevoja për ta bërë këtë pyetje.

13          KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Kërkimi i sqarimit ishte i përshtatshëm, por e kuptoj edhe  
15 qëndrimin e palës Mbrojtëse kur thotë që, mund të ishte thënë  
16 që në një moment të caktuar ai ka thënë që ka shkuar vërtetë  
17 në Zllash.

18          Tani për tani mund të them që dëshmitari e ka bërë të  
19 qartë që e ka thënë edhe atëherë edhe e ka thënë edhe sot të  
20 njëjtën gjë. Pra, që ka qenë atje. E kuptoj qëndrimin tuaj i  
21 nderuar Avokat i Mbrojtjes.

22          Prokuroria mund të vazhdojë tani.

23          Z. Dëshmitar, vendosini dëgjueset prapë. Faleminderit.

24          DËSHMITARI: S'ka përse.

25          ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

1 Py. Mirë. Lidhur me kohën, afatin kohor kur jeni takuar me z.  
2 Salih Mustafa. Siç e kuptova unë nga provat e sotme, ju keni  
3 qenë dy herë në vitin 1998 edhe disa herë të tjera në 1999.  
4 Pra, dy herë në 1998 apo jo, që keni takuar dhe z. Salih  
5 Mustafën, dy herë keni qenë?

6 Pë. Nuk e di nga e kuptove ti, nga e nxore këtë konkluzion.  
7 Njëherë e kam takuar në Zllash dhe një herë në Bajgore apo në  
8 Zabërxhë. Nga e ke nxjerrë ti konkluzionin, është çështje e  
9 jotja.

10 Py. Pra nëse e keni takuar...

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
12 Prokurore, ju lutem citoni ku e ka thënë këtë në mënyrë që të  
13 ballafaqojmë me atë që ka thënë në të vërtetë.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në fakt e citova më përpara,  
15 ishte në fillim të pyetjes sime, por unë po e përsëris.

16 Py. Siç e kuptova unë nga evidencat e sotme, ju e keni takuar  
17 z. Salih Mustafa një herë, ju thatë mbase korrik 1998, në  
18 Bajgore. Kjo ishte hera e parë në vitin 1998, apo jo?

19 Pë. E nderuar Gjykatë. Nuk e di për të satën herë po e ri  
20 përsëris. Në kontekst çfarë e qysh e kupton znj. Prokurore,  
21 është çështja e saj. Unë e thashë, në korrik të '98 e kam  
22 takuar në Bajgore. I kam sjellë disa ushtarë për ushtrime. Dhe  
23 herën e dytë e kam takuar diku në tetor.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Ndaloni pak. Ju lutem, z. Dëshmitar, të gjithë po përpiqemi të

1 respektojmë të dëgjojmë njëri-tjetrin. Znj. Prokurore po citon  
2 nga transkripti ato që keni thënë ju, që zbardhen aty dhe po  
3 përpiqet t'i qartësojë, thjesht t'i qartësojë.

4 Komente të tipit "s'e di unë nga e nxore", pyeta si  
5 Avokatin dhe Prokurorinë të citojnë saktësisht ato që ka thënë  
6 dëshmitari. Nuk po përpiqemi të të themi gjëra që s'janë,  
7 thjesht po verifikojmë thjeshtë ato që janë thënë. Dhe po  
8 përpiqemi të respektojmë njëri tjetrin kur flasim.

9 Ju thoni që e keni parë mbase rreth korrikut.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për procesverbal, faqja 16,  
11 rreshti 9 i transkriptit, për periudhën korrik '98 dhe  
12 vendndodhja Bajgor ka qenë në faqen 15 rreshti 16 i  
13 transkriptit të sotshëm.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Hiqi  
15 pak dëgjueset z. Dëshmitar, z. Parduzi. Faleminderit.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala  
18 është për ju.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se pika e dëshmitarit nuk  
20 ishte çështja e datës së përafërt, por koha, sa herë. Dhe  
21 citimi që përdori Prokurorja thotë vetëm një herë këtu, të  
22 paktën në faqen 16 fitet vetëm për një herë, rreshti 9.  
23 Prandaj besoj se citimi, nëse flasim tani për dy herë në vitin  
24 '98, atëherë citimi duhet të jetë i saktë.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në fakt do të përmendja edhe

1 herën e dytë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
3 ndërpreva unë.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Më falni, s'e kuptova. Mendova se  
5 i përfshiu të dyja në një, në faqen 16, rreshti 9. Sepse atje  
6 flitet vetëm për një rast.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
8 bëjmë të gjithë të pamundurën. Faleminderit që na e saktësuat.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po e merrja hap pas hapi për  
10 t'ju përgjigjur ju, të nderuar Gjykatës, për të cituar edhe  
11 një herë transkriptin.

12 Py. Pra hera e parë...

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Presim pak. Vendosni dëgjueset. Faleminderit z. Parduzi.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

16 Py. Z. Parduzi, siç tha edhe znj. Gjykatëse, ne lexuam nga  
17 transkripti se hera e parë që keni thënë se keni takuar z.  
18 Salih Mustafën, ishte në korrik 1998 me shumë gjasa në  
19 Bajgore. Hera e dytë, thatë se e keni takuar ose e keni parë  
20 në vitin 1998 përsëri, ishte kur shkuat në Zllash për të çuar  
21 disa armë dhe municione në tetor të vitit 1998. Faqja 20,  
22 rreshtat 13 dhe 14 të transkriptit të sotshëm. Ju kujtohet që  
23 i thatë këto?

24 Pë. Po. Unë e përsërita për të saten herë.

25 Py. Në rregull. Prandaj thashë nga transkripti i sotshëm, ne

1 dëgjuam sot se e keni takuar z. Salih Mustafa dy herë në vitin  
2 '98. Pastaj unë do të vazhdoja më tej tek pika e radhës që  
3 ishte të qartësoja ato çka thatë në të shkuarën në deklaratën  
4 e Mbrojtjes në shkurt të vitit 2021.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe për këtë, e nderuar  
6 Gjykatëse, ne mund të hapim deklaratën që është në fakt në  
7 ekran. Dhe më duhet faqja 2 si fillim në versionin e  
8 anglishtes.

9 Në fakt në faqen 2 flitet për takimin e parë në vitin  
10 '98. Por unë doja ta krahasoja me faqen 5 të deklaratës në  
11 anglisht. Paragrafi në fund të faqes, në faqen 5 paragrafi  
12 afër fundit. Paragrafi i parafundit, më falni. Në fund të  
13 faqes dhe paragrafi i parafundit.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Më falni, e nderuar Gjykatëse.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
16 Dëshmitar, hiqi pak dëgjueset ju lutem.

17 Avokat i Mbrojtjes, fjala është për ju.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po e nderuar Gjykatëse. Citimi i  
19 faqes 20, rreshti 13 dhe 14. Aty thuhet:

20 "Datat s'i mbaj mend".

21 Kështu fillon.

22 "Nuk mbanim atëherë ditarë për të mbajtur shënim datat  
23 sepse jeta ishte shumë dinamike, situata qe dinamike. Nëse nuk  
24 e mbaj mend gabim, ka qenë tetor, fundi i tetorit 1998, kur  
25 çova disa armë dhe municione atje dhe mora disa furnizime nga



1 Zllashi, sepse kishte një qendër për furnizim atje për të  
2 plotësuar nevojat e personave që kishin nevojë”.

3 Por kjo nuk do të thotë dhe nuk nënkupton, siç tha  
4 Prokurorja, që ky ishte një takim apo që e pa atje. Po flasim  
5 thjesht për faktin që ka shkuar në Zllash, apo po flasim që ka  
6 parë diku z. Mustafa? Sepse unë mendoj se këtu kjo nuk ishte  
7 në përgjigjen e dëshmitarit në këtë citim që na dha dhe  
8 Prokurorja.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Prania e  
10 z. Mustafa është në faqen 24, rreshti 11 dhe 12.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Na e  
12 lexoni. Do ta gjejmë dhe ne dhe ta shikojmë ndërkohë.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po e lexoj nga rreshti 6,  
14 përgjigja, më falni nga rreshti 3 që të jetë e qartë për cilën  
15 periudhë kohore po diskutojmë. Pyetja e Z. Shala ishte:

16 “Z. Dëshmitar, në kohën kur ishit në Zllash, rasti kur  
17 çuat armët atje, a ju kujtohet kujt ia dorëzuat ato armë”?

18 Dhe përgjigja ishte:

19 “Ja dorëzova në ndërtesën ose shtabin. Sepse shtab i  
20 quanim edhe shtëpitë private, sepse s’kishim kazerma ushtarake  
21 apo ushtri të rregullt”.

22 Dhe pastaj përmend disa persona, që s’është nevoja t’i  
23 përmend. Në fund të fjalisë thotë, nga fundi i rreshtit 11,  
24 rreshti 12 thotë:

25 “Dhe ndërkohë Salih Mustafa erdhi aty”.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
2 Avokat, për të qenë e sinqertë, unë e mbaj mend që kjo u tha  
3 nga dëshmitari më herët, sot paradite. Dhe mendoj se znj.  
4 Prokurore thjesht po citon pasazhet, pjesët për të cilat  
5 flitet për këto raste specifike.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Por pika ime ishte, citimi që tha  
7 ajo, që tha ku thuhet se ka parë z. Mustafa, nuk ishte citim i  
8 saktë i faqes, nuk thuhet në faqen 20 që ka parë z. Mustafa.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por  
10 ajo i citoi të dyja pjesët.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] S'i mbaj mend a citova të dyja.  
12 Mbj mend se çfarë tha dëshmitari dhe po përpiqem t'i përmend  
13 të gjitha referencat nga transkripti i sotshëm, por nuk  
14 keqinterpretova asgjë.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Vetëm këtë pikë kisha për të  
16 ngritur.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
18 mbani mend ju që ai e tha këtë gjë sot?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë po lexoj transkriptin dhe po  
20 them që pyetja lidhej me rreshtin 13 dhe 14.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
22 lutem, e kuptoj pyetjen tuaj, por herën tjetër ne të gjithë e  
23 dimë që u tha sot paradite që ishte atje në tetor. Mund të  
24 thuash që citimi nga znj. Prokurore nuk qe i saktë. Ishte një  
25 citim tjetër. Por ama nuk po thoshte diçka nga vetja, nuk po

1 thoshte diçka që ai nuk e ka thënë në të vërtetë. Do na  
2 ndihmonte të shpejtonim pak pjesën e pyetjeve. Jam krejt --  
3 pajtohem me ju që nëse znj. Prokurore po thotë diçka dhe po  
4 keqpërdor ato që tha ai, ne nuk duhet ta lejojmë. Por me sa  
5 duket nuk ishte kjo dhe ju e dini që u tha në të vërtetë. Dhe  
6 kjo vlen për të gjithë këtu.

7 Znj. Prokurore, vazhdoni me pyetjet.

8 Më falni, thashë vazhdoni, por duhet që z. Dëshmitar të  
9 vendosi dëgjueset. Ju lutem, vendosini dëgjueset z. Dëshmitar.  
10 Faleminderit, z. Dëshmitar.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Duhet ta kisha plotësuar faqen  
12 20 me faqen 24. Ju kërkoi ndjesë që s'e thashë. Por po  
13 përpiqem të përdor të gjitha ato që u përmendën sot paradite.  
14 Por unë e mbaj mend që ju e thatë dhe e verifikova dhe nuk po  
15 thosha asgjë nga vetja. Faleminderit.

16 Py. Z. Parduzi, për t'ju kthyer pyetjes se sa herë e keni  
17 parë z. Mustafa në '98. Sot na thatë 2 herë e kam parë në  
18 vitin '98. Saktë?

19 Pë. Për të dhjetën herë po e konfirmoj që, po. Me falni.

20 Py. Në rregull. Unë doja një qartësim sa i takon deklaratës  
21 suaj të shkurtit 2021. Faqja 5 e kësaj deklarate dhe unë do të  
22 lexoj fjalinë ku ju flisni për herët që keni takuar z. Salih  
23 Mustafa. Thjesht po shkoj në fund të fjalisë, sepse bëhet  
24 fjalë për vitet dhe jo për vendndodhjet dhe pastaj flasim për  
25 më tej. Ju thatë, hera e parë, po flisnit për ngjarjet që i

1 paraprinë, përpara se të plagoseshit dhe sa herë keni takuar  
2 z. Mustafa. Dhe ju thate:

3 "Hera e parë ishte në vitin 1998 dhe kësaj here, ishte  
4 hera e dytë, ishte në vitin 1999".

5 A ju kujtohet t'i keni thënë deklaratës së Mbrojtjes që  
6 vetëm 1 herë e keni parë në 1998?

7 Pë. E nderuar Gjykatë. Unë i them ato çka unë i mbaj mend dhe  
8 i di, dhe jo çka dëshiron Prokuroria ta nxjerr në kontest. E  
9 kam dhe po e ripërsëris, në deklaratën time dhe këtu e  
10 deklaroj që e kam takuar dy herë. Mund të jetë ngatërresë, por  
11 kam thënë në korrik edhe në tetor. Herën e parë në Bajgore  
12 edhe herën e dytë në Zllash. E kam takuar kur kam dërguar disa  
13 armë edhe municion edhe kam marrë disa gjëra ushqimore. Qoftë  
14 veshmbathje apo mbulesa apo ushqimore i kemi marrë. Këtë e kam  
15 thënë dhe këtë e konfirmoj.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
17 Dëshmitar, nuk po përpiqemi të keqinterpretojmë ato që keni  
18 thënë ju në të shkuarën. Thjesht po përpiqemi ose më saktë  
19 znj. Prokurore po përpiqet t'ju tregojë ato që keni thënë më  
20 përpara në të shkuarën dhe çfarë po thoni sot. Në qoftë se ju  
21 mendoni se ka një keqkuptim, na e qartësoni na e sqaroni. Por  
22 ajo nuk po citon asgjë veç atyre që ju në të vërtetë keni  
23 thënë në të shkuarën. Kjo po ndodh këtu. Ju mund të na e  
24 sqaroni si ta kuptojmë neve atë që është në deklaratën që i  
25 keni dhënë Mbrojtjes. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Kjo dhe

1 vetëm kjo.

2 Znj. Prokurore, vazhdoni.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

4 Py. Z. Parduzi, po përpiqesha ta kuptoja këtë pjesë dhe  
5 pyetja ime ishte: Pse nuk përmendet në deklaratën e Mbrojtjes  
6 hera e dytë që jeni takuar me z. Mustafa në Zllash në vitin  
7 '98. Pra, pse nuk përmendet këtu?

8 Pë. Sigurisht s'mu ka bërë pyetja dhe s'jam përgjigj. Por unë  
9 besoj se jam përgjigj.

10 Py. A mund të na e shpjegoni pse këtu keni thënë se e keni  
11 takuar herën e parë, thoni në 1998 dhe herën e dytë në vitin  
12 1999? Në e shpjegoni dot pse është thënë kështu?

13 Pë. Asnjëherë nuk e kam deklaruar që herën e dytë në 1999 e  
14 kam takuar. Asnjëherë dhe në asnjë rast. E kam thënë dhe për  
15 të disatën herë po e përsëris. Në korrik të 1998 e kam takuar  
16 për herë të parë edhe në shtator, fundi i shtatorit apo në  
17 tetor, për herë të dytë. Herën e parë në Bajgorë, herën e dytë  
18 në Zllash. Këtë e kam thënë, këtë e konfirmoj edhe kështu  
19 është.

20 Py. E kuptoj, z. Parduzi. Por unë po citoj ato që keni thënë  
21 ju. Këtu thuhet që: "... herën e dytë, në 1999". Këto janë  
22 fjalët tuaja, nga deklarata juaj.

23 Pë. Nuk e di sa po jam i qartë. Unë po e them, pyetja që më  
24 është bërë, unë jam përgjigj. Mundesh edhe ti shumë pyetje me  
25 i ik, mos me i shtru e unë s'i përgjigjem. Nesër mund të

1    thuash, pse s'je përgjigj. S'përgjigjem pyetjes që nuk më  
2    shtrohet. Unë i përgjigjem ato pyetje që më shtrohen edhe ato  
3    që i di.

4           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
5    Prokurore, dua t'i them diçka dëshmitarit.

6           Z. Dëshmitar, nuk jemi këtu çfarë ju pyetëm çfarë nuk ju  
7    pyetëm. Nuk po flasim për këtë. Ajo që ne shohim të shkruar në  
8    deklaratë, që është nënshkruar prej jush dhe këtu thoni:

9           "Hera e parë ishte në vitin 1998".

10          Ju e keni thënë këtë.

11          "...kurse tani", po flisni për kohën që u plagosët këtu,  
12    "ishte hera e dytë, pra, më 1999".

13          Nuk ka lidhje me ato që po ju pyesim, por çfarë i keni  
14    thënë juve në të vërtetë Mbrojtjes. Ju këtu jepni vitet  
15    konkrete. Thoni hera e parë dhe pastaj flisni për herën e  
16    dytë. Dhe pikërisht pyetja e znj. Prokurore bazohet në  
17    përgjigjen tuaj.

18          Ju lutem, hiqini pak dëgjueset, z. Dëshmitar.

19          Avokat Mbrojtës.

20          Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Mbase problemi është i njëjti  
21    citim, faqja 24 rreshti 11-12 ku thuhet:

22          "Dhe ndërkohë Salih Mustafa erdhi atje".

23          Kurse herën e parë mesa duket kishte takim në vetvete.

24    Mbase ka një dallim për mënyrën se si është kuptuar kjo, mbase  
25    mund të sqarojmë këtë. Në vend që të thotë thjeshtë "e takova

1 dy herë". Mbase sepse një herë e ka parë, një herë e ka  
2 takuar. Ne nuk e dimë cila qe natyra e kontaktit të dytë, nëse  
3 ka pasur kuptohet ndonjë takim të dytë. Këtë po përpiqem të  
4 them.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po i  
6 qëndroj besnike formulimit të deklaratës. Mendoj se në fakt  
7 mund ta bëjmë edhe këtë.

8 Znj. Prokurore, ua lë në dorën tuaj të vazhdoni. U  
9 përpoqa ta sqaroja dëshmitarin se për çfarë po diskutojmë.  
10 Mbase ka një shpjegim në fakt, që mund ta sqaroni.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
12 Gjykatës. Në fakt, mendoj se dëshmitari iu përgjigj pyetjes  
13 sime. Unë mund ta pyes përsëri. Dhe unë propozoj që nëse  
14 Avokati Mbrojtës dëshiron ta shtrojë ndryshe, le ta bëjë gjatë  
15 kohës që do të ketë pyetjet e veta shtesë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
17 Avokat i Mbrojtjes, do të keni plot mundësi që t'i sqaroni në  
18 pjesën e pyetjeve shtesë.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]  
20 Py. Z. Dëshmitar, thjesht po verifikoj nëse iu përgjigjet  
21 pyetjes së fundit edhe pastaj do të vazhdojmë me pyetjen  
22 tjetër.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull. Kur e pyeta  
24 dëshmitarin dhe tha se këto ishin fjalët që ka thënë në  
25 deklaratë, besoj se e ka dhënë përgjigjen e saktë. Kështu që

1 nuk do të vazhdoj më me këtë pyetje, në qoftë se jeni dakord  
2 ju, të nderuar Gjykatës.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
4 lutem, vazhdoni.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

6 Py. Z. Dëshmitar, tani do flas për kohën për periudhën e  
7 prillit 1999, kur u plagosët. Fillimisht më lejoni t'ju pyes  
8 cilat ishin kushtet tuaja gjatë udhëtimit për të shkuar drejt  
9 Potokut? Në çfarë gjendje ishit? Nga Turuçica drejt Potokut?  
10 Pë. Fatkeqësisht, për të satën herë po ju përgjigjem. Iu  
11 përgjigja pyetjes edhe më herët, por megjithatë mbasi po bëni  
12 pyetjen, këtë po përgjigjem. Kanë qenë kushte jashtëzakonisht  
13 tmerrësisht të rënda.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
15 Prokurore, në fakt jam dakord -- preferoj që të mos i  
16 përsërisim pyetjet.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull. Atëherë po e bëj  
18 pyetjen ndryshe.

19 Py. E kuptova që ishit plagosur rëndë, kështu apo jo?

20 Pë. Po.

21 Py. A mund të na tregoni çfarë plagësh kishit marrë?

22 Pë. Doni me i pa vizualisht, apo veç t'jua përshkruaj?

23 Py. Vetëm na i përshkruaj, të lutem.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Dëshmitar, sigurisht që nuk ju kërkojmë të na i tregoni



1 vizualisht. Thjesht na i përshkruani plagët që kishit marrë.

2 DËSHMITARI: Kam qenë në dy krahët nga snajperi dhe në  
3 pjesën e përparme të gjoksit kam qenë nga Praga.

4 Py. A kishit gjakderdhje shumë gjatë udhëtimit?

5 Pë. Sigurisht që kam pas gjakderdhje sepse kanë qenë plagë  
6 shumë të rënda. Mund t'i merrni me mend çfarë është kundra  
7 ajrori, që ato janë me konventë të ndaluara të përdoren në  
8 objekte civile, përveç kundraajrorit. Mirëpo, fatkeqësisht  
9 shkijet nuk kanë zgjedh mjete, i kanë përdor të gjitha.

10 Py. Na thatë, në faqen 20 rreshti 7 dhe 16 i sotshëm, ju  
11 ishit në një traktor me rimorkio, në një rimorkio traktori për  
12 t'ju transportuar drejt Potokut, apo jo? Kështu na thatë?

13 Pë. E thashë dhe e konfirmoj.

14 Py. A mund të na jepni më shumë hollësi, nëse mundeni nëse i  
15 mbani mend, si udhëtuat, për udhëtimin na tregoni pak më  
16 shumë?

17 Pë. Ju lutem, çka konkretisht po të intereson. Unë jam i  
18 gatshëm me u përgjigj. Konkretizoje çka?

19 Py. Ku po qëndronit, ku ju vendosën saktësisht. Thatë në  
20 traktor me rimorkio, po në cilën pjesë të automjetit ju  
21 vendosën, që ju transportuan?

22 Pë. Traktori nuk është mjet i transportit, por është mjet për  
23 bujqësi. Mirëpo në ato kushte e rrethana çfarë kemi qenë, na  
24 është dash me e përdor edhe atë. Sepse ka qenë e vetmja  
25 mundësi në ato kushte e rrethana çfarë kanë qenë rrugë malore.

1 Py. Ishit i shtrirë në rimorkion e traktorit?

2 Pë. Si duket, znj. Gjyqtare, Prokurorja s'paska qenë në  
3 sallë. I shtrirë normal se s'kam mundur unë me qenë statik se  
4 kam qenë i plagosur tepër rëndë.

5 Py. A kishte ndonjë mjek afër?

6 Pë. Ka pas, jo mjek, por ka pas një student i mjekësisë në  
7 vitin e pestë të mjekësisë. Tash ka doktoruar, është doktor i  
8 shkencës. Në atë kohë s'ka qenë. Ka qenë vetëm student i  
9 mjekësisë.

10 Py. A ju kujtohet emri i këtij studenti të mjekësisë?

11 Pë. Po, më kujtohet.

12 Py. Cili ishte emri?

13 Pë. Samir Shatrolli.

14 Py. A kishte ndonjë tjetër me ty në rimorkio?

15 Pë. Këto pyetje veç po ripërsëriten. Po, ka qenë Nuredin  
16 Ibishi, Leka. Edhe ai ka qenë i plagosur, e thashë edhe ma  
17 herët.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jam  
19 dakord znj. Prokurore, në fakt. E tha, e ka thënë sot, e ka  
20 përmendur këtë pjesë.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] S'e kisha të qartë a ishin në  
22 të njëjtën rimorkio apo kishte dy mjete të ndryshme. Prandaj  
23 thjesht po pyesja më shumë.

24 Py. Mirë. Na the që z. Nuredin Ibishi ose ndryshe Leka, ishte  
25 po ashtu i plagosur dhe ai ishte me ju. A ishte ngjitur me ju

1 në të njëjtin rimorkio, apo ishit në mjete të ndryshme  
2 transporti, po ju transportonin me mjete të ndryshme?  
3 Pë. Jo, ngjitur nuk ishim por ishim në të njëjtën rimorkio.  
4 Sepse ngjitur nënkupton diçka tjetër. Dhe po e them në këtë  
5 rast për herë të parë këtë mbas 23 vitesh, që unë e kam pas  
6 jelekun mbrojtës, e kam heq nga vetja dhe ia kam dhënë  
7 komandant Lekës. Fatmirësisht, zoti dhe fati, ajo e ka  
8 shpëtuar. Sepse sigurisht kish me pësu shumë dëme të rënda po  
9 të mos ta kishte pancirin.

10 Py. Ju po thoni që nuk ishit ngjitur njëri me tjetrin, por  
11 ishit në të njëjtën rimorkio, në të njëjtin mjet transporti.  
12 Pra, ishit të dy në të njëjtin mjet transporti, kështu është  
13 apo jo?

14 Pë. E thashë, ngjitur nuk ishim, por ishim në të njëjtën  
15 rimorkio.

16 Py. A keni humbur ndërgjegjen ndonjëherë apo keni qenë  
17 gjithnjë i zgjuar gjatë gjithë kohës?

18 Pë. Jo, s'kam qenë çdoherë. Kam pas kohë e kam humbur  
19 vetëdijen. Por më është rikthyer, ka pas kohë. Ka pas momente  
20 kur është ndal edhe rimorkio, kemi ba disa pushime sepse ka  
21 qenë rruga tepër, tepër e vështirë. Edhe më është dashtë me  
22 mjeku plagën, është dash me pushu edhe me i dhënë ndonjë bar  
23 qetësues ose ndonjë infuzionin me e vendosë.

24 Py. Për sa i përket kohës kur ju kujtohet që ju është afruar  
25 z. Salih Mustafa, kjo është në faqen 30 rreshti 22, që kjo ka

1 ndodhur diku afër fshatit Rimanishtë, kështu është?

2 Pë. Jo, nuk e thashë ashtu. S'e kam thënë askund ashtu. Kam  
3 thënë rrugës diku, por na ka përcjellë deri në fshatin e  
4 Rimanishtës ose Bellopojë. Por jo në Rimanishtë.

5 Py. A mund të na thoni që ju ka shoqëruar deri në Rimanishtë  
6 ose Bellopojë?

7 Pë. Për të satën herë unë po e ripërsëris. Po, e ka ba  
8 sigurimin e rrugës, mos hasim ndonjë pusi rastësisht edhe e ka  
9 siguruar rrugën. Ka pas raste dy ose tri ose nuk e mbaj mend  
10 saktësisht, që ka ardh dhe më ka pyet. Kur jemi ndal më ka  
11 dhënë infuzion ose diçka. Por më ka pyet miqësisht si  
12 bashkëluftëtar, apo mund të qëndrosh, qëndro edhe pak, do t'ia  
13 dalim, do t'ia dalim. Kjo ka qenë. Por nuk di unë se s'kam pas  
14 busull as hartë me e dit se në cilin fshat dhe në cilën kohë  
15 jemi.

16 Py. Për sa i përket vendndodhjes e kuptoj që nuk na tregoni  
17 dot se ku ekzaktësisht ishit kur ka ardhur për të folur me ju  
18 z. Mustafa, kështu është?

19 Pë. Po pikërisht. Sa herë duhet me i përsërit. Ashtu e  
20 thashë. Ato që i them njëherë, unë i qëndroj mbrapa asaj  
21 çdoherë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
23 lutem, vetëm përgjigjuni pyetjes, z. Parduçi.

24 DËSHMITARI: Parduçi.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Parduzy, ju kërkoj ndjesë. Z. Parduzy, ju e keni fjalën.  
2 Përgjigjuni pyetjes ju lutem. A mund t'i përgjigjeni ju lutem?

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

4 Py. Z. Parduzy, a dëshironi që ta përsëris pyetjen?

5 Pë. Unë pyetjen që e bane u përgjigja tash. Nëse keni pyetje  
6 tjetër, rrëmo, këtu jam unë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Prisni. Nuk është kështu z. Parduzy, nuk funksionon kështu.

9 Nuk shkojnë kështu punët. Kur bëhet një pyetje, unë ju kërkoj  
10 që të jepni përgjigje. Nuk jeni këtu ju për të vendosur se  
11 cilës pyetje t'i përgjigjeni apo jo. Dhe në qoftë se unë  
12 mendoj që është e përsëritur, atëherë nuk do të ketë nevojë  
13 t'i përgjigjeni. Por tani po ju kërkoj me shumë njerëzi që të  
14 t'i përgjigjeni pyetjes.

15 Znj. Prokurore, ju lutemi përsërisni pyetjen tuaj.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

17 Py. Z. Parduzy, pyetja ime ka lidhje me vendndodhjen ku e  
18 keni parë z. Mustafa. Po e lexoj edhe njëherë.

19 "Për sa i përket vendndodhjes, me sa kuptoj unë, ju nuk  
20 jeni në gjendje të na tregoni se ku ekzaktësisht e keni takuar  
21 z. Mustafa gjatë këtij udhëtimi. A ju kam kuptuar siç duhet  
22 apo jo"?

23 Pë. Po, drejtë. Ashtu e kam thënë dhe ashtu është.

24 Py. Vendndodhjen nuk jeni në gjendje të na e tregoni.

25 Megjithatë, sot në faqen 31 thatë që nuk e keni parë z.

1 Mustafa në Potok. Dhe kjo ndodhet në faqen 31, rreshti 22. A  
2 është kjo e saktë? A ju kujtohet që e thatë një gjë të tillë?  
3 Pë. Jo, nuk mund t'i përgjigjem kësaj pyetje kështu, znj.  
4 Gjyqtare. Nëse më lejohet, këtu a po bëhet fjalë për Patok,  
5 apo po bëhet fjalë për pjesën verilindore. Sepse janë dy  
6 çështje të ndara njëra nga tjetra. Përcakto dhe specifiko për  
7 cilën pjese po dëshiron përgjigje. Nuk mundem dy pyetje në  
8 një. Ose e bëjmë edhe këtë, por atëherë nuk merr përgjigje  
9 çfarë dëshiron. Unë e them përgjigjen çfarë e di unë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
11 Dëshmitar, do ta bëjmë pyetjen edhe një herë në mënyrë më  
12 specifike, në mënyrë që të dini se për çfarë të përgjigjeni.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

14 Py. A ju kujtohet, a e dini nëse z. Mustafa ka ardhur deri në  
15 Potok me ju?

16 Pë. Jo, e thashë. Nuk jam i sigurt a ka qenë në Rimanishtë a  
17 Bellopojë, deri aty. Por jo më tutje. Për të pestën herë po e  
18 përsëris që jo, s'ka qenë.

19 Py. A mund të na shpjegoni se si e dini që ka ardhur deri në  
20 Rimanishtë apo Bellopojë, deri në çfarë pike? Si e dini?

21 Pë. Edhe njëherë pyetjen se nuk pata përkthim.

22 Py. Dakord. Si mund ta dini që z. Mustafa ka ardhur deri në  
23 Rimanishtë apo deri në Bellopojë?

24 Pë. Mund ta di që e kam parë me sy.

25 Py. Por ju na thatë pak më parë që nuk ishit në gjendje të

1 thoshit se ku e keni parë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat i Mbrojtjes, jo. Dua që pyetja që bëhet të marrë

4 përgjigje. Nuk do t'jua jap fjalën juve tani.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

6 Py. Z. Parduzi, po e përsëris pyetjen edhe njëherë. Për shkak  
7 se ne deri tani kishim diskutuar se si ju nuk ishit në gjendje  
8 të përmendje një vend të caktuar ku e keni parë z. Mustafa  
9 gjatë këtij udhëtimi. Pyetja që bëra unë është që, si ishit në  
10 gjendje ta kuptonin që ai ka ardhur deri në Rimanishtë apo në  
11 Bellopojë? A mund ta shpjegoni këtë?

12 Pë. Unë e shpjegova, por megjithatë edhe një herë, edhe  
13 njëqind herë nëse doni. Bëhet fjalë për dy pjesë thashë.  
14 Pjesën e parë prej Turuçicë e deri në fshatin Rimanishtë, apo  
15 në Bellopojë, nuk jam i sigurt cila ka qenë. As atëherë, as  
16 tash. Ndalesa e fundit prej aty ka qenë pjesa tjetër për me  
17 kalu në pjesën veri-lindore, për me shku tek spitali. Deri aty  
18 e kemi parë gjatë rrugës, nuk e di në cilat fshatra apo në  
19 cilat vende. Por për herë të fundit aty ku jemi zbrit prej  
20 traktori e na ka marrë pjesa tjetër e Brigadës 151, për të na  
21 transportuar për të na dërguar në spital. Ka qenë hera e  
22 fundit edhe ndarja -- deri aty e ka pas për detyrë.

23 Py. Pra ju po thoni që nuk e keni parë vetëm njëherë, por e  
24 keni parë më shumë se njëherë gjatë këtij udhëtimi. Kështu po  
25 thoni?

1 Pë. Ashtu e thashë edhe ma lart. S'i kam numëruar, njëherë, a  
2 dy, a pesë, a dhjetë. S'i kam numëruar se unë kam qenë i  
3 plagosur. Por po, ka ardh. Kur i ka ardhur mundësia ka ardh më  
4 ka vet, si je, apo mundesh me qëndru, a po mundesh me e  
5 përballu, edhe pak, së shpejti do të arrijmë. E kështu me  
6 radhë. S'i kam numëruar unë, a njëherë, a dy, a tri, nuk e di  
7 sa herë. Por, po, disa herë ka ardh. Që është edhe njerëzore.  
8 Py. Pra, ju po thoni që e keni parë disa herë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
10 Prokurore, e dëgjuaam këtë. Përgjigjen e ka dhënë, nuk ka  
11 nevojë ta përsërisni.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dakord.

13 Py. Dua t'ju bëj disa pyetje të cilat janë bërë gjatë  
14 intervistës që i keni dhënë Zyrës së Prokurorisë së  
15 Specializuar në janar të vitit 2022.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran  
17 transkriptin e kësaj interviste që ka numrin rendor 104544-TR-  
18 ET, Pjesët 2 dhe 3. Dhe kam nevojë për faqen 16, ju lutem.

19 Py. Po lexoj nga fillimi i faqes, rreshti 1. Pyetja që ka  
20 bërë Prokurori ishte.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E shoh që dëshmitari kërkon  
22 fjalën.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Urdhëroni, z. Dëshmitar.

25 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare, unë që në fillim e pata një



1 kërkesë me i shfaq dy shqetësime. Njëra prej tyre ka të bëjë  
2 edhe lidhur me këtë pikërisht, prandaj doni të ma jepni këtë  
3 të drejtë apo doni të ma mohoni?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
5 t'ju jepet fjala për të ngritur shqetësimet tuaja në një  
6 moment tjetër kohe. Por aktualisht dua që të përfundojmë  
7 seancën e pyetjeve. Por juve do t'jua japim fjalën për t'i  
8 treguar Trupit Gjykes ato shqetësimet tuaja më vonë.

9 Vazhdoni znj. Prokurore.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

11 Py. Përpara se të lexoj këtë pjesë, për të cilën dua mendimin  
12 tuaj z. Parduzi, a mund të shpjegoni që ishte z. Mustafa ai  
13 personi me të cilin keni folur?

14 Pë. Pyetjen s'po e kuptoj, çka po don. Cila është pyetja?

15 Py. Si ishit në gjendje ta njihnit apo ta kuptonit që ishte  
16 z. Mustafa, ndërkohë që ju ishit në gjendje shëndetësore të  
17 rëndë?

18 Pë. Unë isha vërtetë në gjendje të rëndë shëndetësore, por  
19 mentalisht isha në rregull.

20 Py. Pra, a mund të na tregoni se si e keni njohur, si keni  
21 arritur ta njihni?

22 Pë. S'po të kuptoj qysh, si kam arrit. Unë e shpjegova, për  
23 sa herë e shpjegova si e kam arrit. E kam parë fizikisht, e  
24 kam njohur. Qysh ndryshe, s'po di me ta përshkrue.

25 Py. Dakord. Po lexoj tani nga transkripti. Pyetja që ka bërë

1 Prokurori ishte se:

2 "Në cilën pikë të udhëtimit tuaj nga Turuçica në Potok,  
3 në cilën pikë, në cilin vend e keni kuptuar fillimisht që z.  
4 Mustafa ishte aty me ju"?

5 Kjo ishte pyetja e bërë. Përgjigja e juaj ishte:

6 "Nuk e di se çfarë nënkuptoni ju me fjalën 'keni takuar'  
7 z. Mustafa. Pasi unë nuk isha në gjendje të lëvizja. Unë isha  
8 i plagosur, por në një pikë të caktuar më kujtohet se ka  
9 ardhur. Më është afruar dhe më ka pyetur se si isha, a po  
10 mbahesha".

11 Dakord deri në këtë pikë? A ju kujtohet? A ju kujtohen  
12 këto fjalë?

13 Pë. Po, sigurisht.

14 Py. Dakord. Atëherë do të vazhdoj. Po lexoj nga rreshti 8:

15 "A ju kujtohet se cili ishte vendi, nëse mund ta thoni,  
16 se ku e keni parë për herë të parë z. Mustafa kur ai po ju  
17 pyeste nëse po mbaheshit"?

18 Dhe përgjigja juaj ishte, në rreshtin 11:

19 "Nuk e di. Për shkak se ishte mbuluar, binte shi i  
20 rrëmbyer dhe do të kisha dashur ta dija se ku kjo ka ndodhur,  
21 por nuk e di".

22 Pë. Edhe cila është pyetja?

23 Py. Pyetja ishte, a mund të konfirmoni këtu që nuk ishit në  
24 gjendje ta kuptonit se ku ekzaktësisht e keni parë z. Mustafa?

25 Pë. Po ju vetë e lexuat pyetjen dhe vetë e morët përgjigjen.

1 Përgjigja është brenda pyetjes. Edhe unë e konfirmoj atë që e  
2 kam thënë.

3 Py. Për sa i përket kohës, momentit kohor, pyetja pasuese  
4 thotë:

5 "A ka ndodhur kjo ndoshta -- e kuptoj këtë shumë mirë. A  
6 e dini nëse kjo ka ndodhur më datën 11 prill" apo "në datën 12  
7 prill? Sigurisht në qoftë se ju kujtohet".

8 Dhe përgjigja juaj, nga rreshti 17:

9 "Nuk e di. Nuk jam në gjendje që ta përcaktoj. Do të  
10 kishte qenë mirë po ta dija, por nuk e di".

11 Pë. Cila është pyetja? A ka pyetje këtu?

12 Py. Thjesht për të konfirmuar që kjo është e saktë, kjo që  
13 keni thënë që, për sa i përket momentit kohor, ju nuk ishit në  
14 gjendje ta dinit se kur e keni takuar z. Mustafa.

15 Pë. Jo kur, po ku. Sepse ka dallim kur edhe ku.

16 Py. Pjesa e parë kishte të bënte me vendin, e konfirmuat që  
17 nuk ishit në gjendje që ta thonit. Dhe pyetja e dytë ka të  
18 bëjë me kur, nëse kjo ishte pak mbasi ishit larguar apo në  
19 ditën e dytë përpara se arrinit në Potok. A mund të na thoni  
20 se kur ka ndodhur që të ketë folur me ty z. Mustafa?

21 Pë. Sigurisht, unë s'po kuptoj çka po don, cila është pyetja  
22 konkrete. Ju lutem, mos e ngatërmoni çështjen e Potokut me  
23 çështjen e rrugëtimit prej Turuçicës. Ndajini këto të dyja  
24 sepse janë ndarazi. Ose nëse s'i ndan i bëjmë të dyja së  
25 bashku, por sigurisht nuk keni me marrë përgjigje, sepse unë e

1 them ato çka është.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Dëshmitar. Në deklaratën tuaj që i keni dhënë ZPS-së, më  
4 lejoni znj. Prokurore, pyetja e bërë ishte:

5 "A e dini nëse kjo ka ndodhur më 11 prill apo më 12  
6 prill"?

7 Kjo ishte pyetja që është bërë, nëse kishit parë z.  
8 Mustafa. Dhe pastaj përgjigja juaj ishte:

9 "Unë nuk e di. Nuk jam në gjendje që ta përcaktoj".

10 Pra, ju i thatë Zyrës së Prokurorisë para disa muajve që:  
11 nuk e them dot nëse ishte më datën 11 apo 12 që e kam parë z.  
12 Mustafa. Dhe tani znj. Prokurore po ju pyet: a është kjo e  
13 saktë? Këtë na e keni thënë neve. A mund t'ia thoni këtë edhe  
14 Trupit Gjykes? Ju e thatë këtë para disa kohësh, por duam ta  
15 konfirmosh apo jo. Pra, atë që keni thënë atëherë, ne duam ta  
16 dimë nëse është e saktë. Nëse mund të thoni apo nuk jeni në  
17 gjendje të thoni që në ato data e keni parë z. Mustafa. Pasi  
18 para disa kohësh i keni thënë Zyrës së Prokurorisë që nuk e  
19 dini saktësisht se kur ka ndodhur.

20 Kjo ishte pyetja që ju është bërë, z. Parduzi. Kjo është  
21 pyetje, z. Parduzi, është pyetje. A mund të konfirmoni që nuk  
22 jeni në gjendje të thoni tani se kur e keni parë atë gjatë  
23 këtyre 2 ditëve?

24 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare. Nuk kanë qenë dy ditë, por kur  
25 i llogarit me data ato janë dy ditë. Por në fakt kanë qenë

1 ditë të gjata, janë tri. Data 10 që jam nis me më  
2 transportuar, ka qenë tërë natën e mesi i natës në orën 24:00  
3 kemi hy veç në datën e 11 prillit. E kemi udhëtu gjithë ditën  
4 a prapë në orën 24.00 të mbrëmjes ka hy data 12. Nuk mund e di  
5 unë se s'kam pas orë me këqyr a është 10, a është 11, a 12.

6 Prandaj s'mund të them unë që ka qenë 10, 11 apo 12. Këtë  
7 e kam thënë edhe këtë po e them edhe sot. Nuk e di se cila ka  
8 qenë data, se s'kam pas kohë të mendoj sa është ora dhe data.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj  
10 se e kuptoj këtë që thoni ju. Faleminderit. Mjafton si  
11 përgjigje.

12 Vazhdoni znj. Prokurore.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
14 Gjykatëse.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ju  
16 kujtoj që po i afrohem orës 13.15. Kështu që përfundoni këtë  
17 temë të pyetjeve dhe të na tregoni neve Trupit Gjykses se edhe  
18 sa kohë do t'ju duhet për kundra pyetjet tuaja.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, unë do të  
20 përfundoj në këtë fushe, do të marrim pushimin dhe më pas  
21 besoj se më mbetem 10 minuta gjithsej.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

25 Py. Z. Parduzi, një pyetje përfundimtare për të kuptuar

1 periudhën në kohë kur e keni parë z. Mustafa, nëse ju  
2 kujtohet. A ju kujtohet nëse e keni parë apo keni folur me të  
3 nga Zllashi në Rimanishtë, apo më pas?

4 Pë. Në asnjë rast Zllashin s'e kam potencuar unë.

5 Py. Turuçicë. Kërkoj ndjesë, Turuçicë. Është gabimi im.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë  
7 deshët të thoshit ju Avokat i Mbrojtjes?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Desha të thosha nga Turuçica në  
10 pikën ku është transportuar dëshmitari për në drejtim të  
11 Potokut.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.  
13 Vazhdoni.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

15 Py. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet nëse kjo ka ndodhur në mes të  
16 Turuçicës dhe Rimanishtës, apo në Rimanishtë, që ju kujtohet  
17 që të keni folur me z. Mustafa.

18 Nëse nuk jeni në gjendje që të përgjigjeni, nuk ka  
19 problem.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
21 Prisni. Dëshmitar, hiqini dëgjueset ju lutem.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Kjo pyetje, të nderuar Gjykatës,  
23 është përsëritur disa herë, është thënë disa herë që kjo ka  
24 ndodhur në këtë trajektore midis Turuçicës dhe Rimanishtës.  
25 Janë këto pikërisht vendet në të cilat ai ka folur apo ka

1 pasur kontakt me Z. Mustafa.

2 Kjo pyetje është bërë disa herë dhe përgjigjen e ka dhënë  
3 vetë dëshmitari.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
5 Prokurore, ju e keni fjalën.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po përpiqesha të bëja një afat  
7 kohor. Ndoshta mund ta ripërsëris, duke mos përmendur  
8 vendndodhjen.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
10 shikoni çështjen që ka ngritur Mbrojtja. Pasi këto pyetje janë  
11 bërë më përpara.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Z. Parduzi po vendos kufjet.  
13 Py. Faleminderit z. Parduzi. Pyetja e fundit për sa i përket  
14 kohës kur ka ndodhur ky takim. A ju kujtohet nëse kjo ka  
15 ndodhur pak pas jeni larguar nga Turuçica, apo më vonë gjatë  
16 këtij udhëtimi përpara se të arrinit në Rimanishtë? Pra gjatë  
17 kësaj kohe që të keni folur me z. Mustafa?

18 Pë. Te lutem, unë s'po e kuptoj esencën e pyetjes, cila është  
19 pyetja konkrete. A e keni takuar? Unë thashë që e kam takuar.  
20 Ku ka qenë? Unë nuk e di ku ka qenë. Nuk kam qenë unë në  
21 helikopter e me e dit ku është vendi. Thashë e kam takuar, më  
22 ka takuar në fakt, se unë s'kam pas mundësi me e taku atë. Por  
23 më ka takuar në momentet kur jemi ndal, goftë për ndonjë  
24 pushim të shkurtër që është dashtë me ma dhënë një infuzion,  
25 apo ndonjë injeksion për shkak të dhimbjeve edhe një pushim të

1 shkurtër për me vazhdu.

2 Ku ka qenë? Sigurisht është ndal, ka ardh më ka pyet  
3 sepse ka qenë edhe kohë -- ka qenë e mbuluar rimorkio me një  
4 llastik se kanë qenë reshjet atmosferike jashtëzakonisht të  
5 mëdha. Ka qenë ftohtë. Edhe më ka pyet, "si je, a po mundesh  
6 ta përballosh, durim edhe pak, do t'ia arrijmë, do t'ia  
7 dalim". Këto kanë qenë. Edhe ka ec ai, ka vashdu, se e ka pas  
8 detyrën për me siguru udhëtimin.

9 Nuk e di sa herë duhet me i shpjegu. A po nëse doni  
10 gjithë ditën, unë ta shpjegoj, nuk është problem. Kam tema me  
11 fol një javë. Po thjesht unë po përpiqem me qenë sa më shkurt.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë  
13 temë ta përfundojmë.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, këtë desha të thosha edhe  
15 unë. Dakord.

16 Unë e kam përfunduar këtë tematike, të nderuar Gjykatës.  
17 Kështu që mund të marrim pushimin dhe siç e thashë vetëm 10  
18 minuta do të më ngelen mbas pushimit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Faleminderit, znj. Prokurore.

21 Znj. Asistente, ju lutem ta shoqëroni dëshmitarin jashtë  
22 sallës.

23 Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim deri në orën  
24 14.30. Dhe më pas do të kemi edhe një seancë tjetër që do të  
25 zgjasë 90 minuta. Ju uroj një drekë të mirë.



1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, znj. Asistente.

4 Për sa i përket planifikimit të punës, Mbrojtësja e  
5 Viktimave, a mund t'i tregoni Trupi Gjykues tani nëse do të  
6 keni pyetje për të bërë?

7 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Faleminderit. Nuk e themi me  
8 siguri të plotë, por me sa duket nuk do të kemi pyetje për të  
9 bërë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Atëherë do të bëjmë një pushim që do të zgjas një orë e  
13 15 minuta.

14 Takohemi sërish në orën 14.30.

15 Seanca pezullohet.

16 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.13

17 --- Seanca rifillon në orën 14.30

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

19 se u kthyet. Jemi në të njëjtën përbërje sikurse dhe para  
20 pushimit, kështu që kjo shënohet për procesverbal edhe  
21 vazhdojmë me kundrapyetjet për Dëshmitarin 900 nga Zyra e  
22 Prokurorit të Specializuar.

23 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem a mund të sillni  
24 dëshmitarin.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Mirë se erdhët  
2 z. Parduzy.

3 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Urojmë të kesh pushuar pak.

6 DËSHMITARI: Po, mirë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
8 do të vazhdojmë me pyetjet që do ju drejtojë znj. Prokurore.

9 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
11 Gjykatëse.

12 ZNJ. D'ASCOLI:

13 Py. Mirëdita z. Parduzy. Sot paradite na thatë që ishit  
14 anëtar i Brigadës 151. Faqja 12, rreshti 8. A punuat me  
15 Nuredin Ibishin gjatë kohës që ishte komandant i Brigadës 151?

16 Pë. Jo vetëm se kemi punue, po edhe kemi luftue dhe tërë  
17 kohën kemi qenë së bashku e thashë.

18 Py. A kishit ndonjë rol apo detyrë konkrete kundrejt -- në  
19 raport me z. Ibishi?

20 Pë. Detyra kam pasë në raport me Ushtrinë Çlirimtare të  
21 Kosovës.

22 Py. Po me z. Ibishi a kishit ndonjë rol specifik për të?

23 Pë. Në çfarë konteksti? Kokretizoje çka.

24 Py. Cilat ishin detyrat tuaja kundrejt tij, kundrejt z.  
25 Ibishi?

1 Pë. Detyrat e mia kanë qenë kundrejt Ushtrisë Çlirimtare dhe  
2 obligimet që kemi pasë, se detyra specifike ndaj asnjë  
3 individi s'ka pasë kurrkush. Po kemi pasë detyra të caktume  
4 dhe të përcaktume me luftu armikun aty ku të mundim.

5 Py. A ishit ju përgjegjës për mbrojtjen e tij?

6 Pë. Nuk e di si ta them - përgjegjës. Përgjegjës ka qenë  
7 gjithkush për vetveten por po kemi qenë së bashku gjithë  
8 kohës.

9 Py. A ishit ju, a i ofronit sigurinë z. Ibishi. Pra ishit ju  
10 përgjegjës për sigurinë e z. Ibishi?

11 Pë. Sigurinë e ka bo gjithkush për vetvete. E kemi pasë  
12 sigurinë në popull, jo specifikisht. Se asht term i gjanë  
13 siguria.

14 Py. Në fakt pyetja ime ishte konkrete.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
16 Dëshmitar, përpiquni t'i përgjigjeni pyetjes.

17 DËSHMITARI: Znj. Prokurore, në dijeninë teme po bëj  
18 përpjekje maksimale që të jem sa më konciz e sa më i saktë.  
19 Nuk e di nëse nuk i përmbush kërkesat e Prokurorisë, atëherë  
20 unë muj të zgjerohena. Por unë thjesht e dhashë përgjigjen  
21 time, e cila besoj që është e mjaftueshme.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

23 Py. A ishte një nga detyrat tuaja konkrete gjatë shërbimit në  
24 UÇK - pra një nga detyrat, a ishte që të shoqëronit z. Ibishi,  
25 ta siguronit, t'i ofronit mbrojtje fizike z. Ibishi?

1 Pë. Mbrojtje fizike, sigurinë unë s'kam mujt me ja bo  
2 askujna, s'mujt as vetit. Por sigurinë e kemi pasë nga populli  
3 edhe për popullin. Çdo njoni, e kemi pasë, por kemi  
4 bashkëvepruar së bashku.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
6 Dëshmitar, thjesht thuaj "po" ose "jo" për këtë pyetje.  
7 Përgjigju me "po" ose "jo".

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Znj. Gjyqtare, nuk mund të them  
9 unë se "po" ose "jo" me vetë faktin që po them 24 orë kemi  
10 qenë së bashku. Nëse mund të quhet ajo siguri, atëherë le të  
11 mbetet q'ashtu, por s'mund të them unë "po" ose "jo."

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
13 dua t'i vë emër, sepse ju jeni dëshmitari për Mbrojtjen këtu.  
14 Nuk më takon mua. Por ju a ofronit siguri, pra si bodigard e  
15 thënë ndryshe, siguri fizike për këtë person apo jo?

16 DËSHMITARI: Jo vetëm për këtë, po për asnjë komandant nuk  
17 ka pasë siguri në kuptimin që jo - po e dëshifroni ashtu -  
18 sepse nocioni "siguri" len shumë, është nocion i gjanë. Ne  
19 kemi qenë së bashku, kemi rrugëtue, e kemi mbrojt njoni  
20 tjetrin, por jo specifikisht vetëm në detyrë me thonë ky ose  
21 ai. S'ka pasë asnjë. S'kemi qenë në ato kushte ndaj.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]  
23 Py. Në fakt po i referohesha kësaj sepse është në dëshminë  
24 tuaj në çështjen Latif Gashi dhe të tjerë. E mbani mend që  
25 keni dhënë dëshmi?

1 Pë. Në çfarë konteksti ka të bëjë kjo tash me - ai ka qenë  
2 proces i vitit 2002, procesi i grupit të Llapit. Po e mbaj  
3 mend që kam dhënë dëshmi.

4 Py. Ju kërkoj ndjesë z. Dëshmitar. Pyetja ime ishte: A ju  
5 kujtohet që keni dhënë dëshmi për këtë çështje? S'kishte  
6 lidhje me kontekstin, po a e mbani mend që keni dhënë dëshmi  
7 për këtë çështje?

8 Pë. Po e mbaj mend. Por atë deklaratë nuk e kam nënshkrue  
9 sepse nuk është ofrue në gjuhën shqipe, vetëm në gjuhën  
10 angleze dhe s'e kam nënshkrue. S'kam pranue se si të tillë -  
11 as e mohoj, as e pohoj -- po s'e kam nënshkrue thjesht.

12 Py. Në rregull. Në këtë kontekst, z. Dëshmitar thatë që  
13 detyrat tuaja, detyrimi juaj ishte ndër të tjera, njësoj si  
14 detyrimet për ofrimin e sigurisë për një person të  
15 rëndësishëm, siç ishte dhe Komandant Leka.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe i referohem ZPS-së 00120322  
17 [sipas përkthimit] deri në 00120243 në faqen 2.

18 Py. Detyrat tuaja a përfshinin dhe ofrimin e sigurimit për  
19 Komandant Lekën?

20 Pë. Me vetë faktin që e thashë, deklaratën nuk e kam  
21 nënshkru, nuk e njof edhe si të tillë. Nëse ma ban pyetjen  
22 konkrete unë ju përgjigja konkretisht. Thashë, po kemi qenë të  
23 24 orët së bashku. Kemi punue dhe kemi bashkëveprue së bashku.

24 Py. Më falni, z. Dëshmitar, a mund t'i përgjigjeni pyetjes?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe

1 unë në fakt i mëshoj kësaj.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

3 Py. Dhe është një pyetje që mund t'i përgjigjesh me "po" ose  
4 "jo" në kuadër edhe të dëshmisë suaj të mëparshme.

5 Pë. Përderisa nuk e kam nënshkrue, si mund të mirret si  
6 dëshmi ajo? Thjesht nuk më është ofrue asnjëherë, as nuk e kam  
7 lexue, as nuk është afrue, as s'e kam nënshkrue.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
9 Prokurore, që ta kuptoj dhe unë. Po shoh në faqen 12. Po shoh  
10 faqen 12 të deklaratës të cilën përmendët ju -- është e 23  
11 shtatorit 2002 apo jo? A për këtë po flasim, deklaratën e 23  
12 shtatorit 2002, faqja 12 shoh një nënshkrim nën fjalën  
13 "Dëshmitar Kapllan Parduzi". Këtu shikoj një firmë.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mbase mund të nxjerrim numrin  
15 rendor SPOE00120232 deri në 00120243. Nëse shkojmë në faqen 7  
16 të këtij transkripti. Pikësëpari ta zmadhojmë pak në fund të  
17 faqes, afër fundit të faqes.

18 Py. Z. Dëshmitar, a është ky nënshkrimi juaj?

19 Pë. Jo, ky është i fallsifikum. Unë e thashë edhe ma herët,  
20 nuk është e vërtetë edhe nuk e kam nënshkrue deklaratën sot se  
21 nuk më është ofruar në gjuhën shqipe.

22 Py. Pra ju po thoni që kjo nuk është firma juaj.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirë. Shkojmë në faqen e  
24 fundit, në faqen 12 thjesht për të parë një firmë tjetër.

25 Py. Ku thotë "Dëshmitari Kapllan Parduzi" a është kjo firma

1 juaaj në faqen 12?

2 Pë. Në fund po.

3 Py. Pra e keni nënshkruar këtë deklaratë apo jo?

4 Pë. Nuk e kam nënshkrue deklaratën e thashë edhe njëherë. E  
5 them me përgjegjësi edhe penale. Nuk është e vërtetë. Edhe në  
6 seancën e hapur që është mbajt në gjykatë në Prishtinë, mund  
7 t'i merrni procesverbalet, nuk e kam nënshkrue deklaratën  
8 sepse nuk është ofruar në gjuhën shqipe.

9 Py. Në rregull. Z. Dëshmitar, a nuk na thatë që e njihni këtë  
10 firmë? Sapo na thatë që e njihni që kjo firmë është e juaja në  
11 faqen e fundit.

12 Pë. Unë e konfirmoj që firma si firmë është e jemja,  
13 nënshkrimi është i imi, mirëpo në këtë dokument edhe në gjuhën  
14 angleze unë nuk kam pranue s'e kam nënshkrue.

15 Py. Në rregull. Ky është versioni i gjuhës angleze.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund ta shikosh dhe gjuhën nëse  
17 shkojmë më lart.

18 Py. Në anglishte është transkripti. E shihni që është në  
19 anglishte?

20 Pë. Znj. Gjyqtare, me vetë faktin që ka qenë prezent edhe  
21 Avokati Ahmet Gashi, i cili nuk e ka firmën. Mund ta  
22 konfirmoni në çdo kohë dhe në çdo rrethanë. Dhe e them edhe  
23 njëherë me përgjegjësi edhe morale edhe penale: nuk e kam  
24 nënshkruar deklaratën, e cila më është ofrue në gjuhën  
25 angleze. Kam kërkuë që të përktheht në gjuhën shqipe, ta

Dëshmitari: Kapllan Parduzi (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 96

1 lexoj, ta konfirmoj edhe ta firmosi. Megjithatë, nuk më është  
2 mundësue prandaj edhe nuk e kam nënshkrue.

3 Py. Në rregull.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Atëherë më duhet një pohim.

6 A e shihni që deklarata është në anglisht? E shihni që  
7 është në anglisht?

8 DËSHMITARI: Po, po e shof.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe  
10 këtu po shihni dhe nënshkrimin tuaj në tekstin në anglishte?

11 DËSHMITARI: Po, po.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirë, shkojmë te faqja 7,  
13 SPOE00120238. Më duhet pjesa e fundit e transkriptit.  
14 Faleminderit.

15 Py. Po lexoj pyetjen dhe përgjigjen që është bërë aty.

16 Pyetja:

17 "Kur ndaluat të ishit badigardi apo roja trupore e  
18 Komandant Lekës?"

19 Dhe përgjigjja juaj ishte:

20 "Puna ime si roje trupore apo badigard ndaloi kur u  
21 plagosëm të dy në betejën e Surdullit, besoj më 9 ose më 10  
22 prill."

23 A ju kujtohet kjo?

24 Pë. Si pyetje, po.

25 Py. Ju dhatë një përgjigje konkrete z. Dëshmitar. A ju



1 kujtohet që ju dëshmuat që ishit, pra ofronit siguri trupore  
2 dhe konkretisht këtu thua puna ime si roja e tij trupore apo  
3 badigardi i tij. A ju kujtohet kjo?

4 Pë. Në fakt mos i ngatërroni gjonat. Unë edhe njëherë po e  
5 them, nuk ka pasë detyrë specifike. Ne kemi qenë 24 orë së  
6 bashku dhe në kontekst sigurisht e kanë nxjerrë edhe ka mujt  
7 kështu me qenë. Po unë e kom thonë edhe prapë po e përsëris:  
8 Ne 24 orë kemi qenë së bashku, jo në cilësinë e asnjë sigurimi  
9 të afërm por në cilësinë e ushtarit sepse çdo njeni kemi pasë  
10 sigurinë për vetveten edhe me e rujt njeni tjetrin.

11 Py. Në rregull. Z. Dëshmitar, këto janë fjalët tuaja që unë  
12 thjesht ua lexova pa interpretuar. Këto ishin fjalët tuaja.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të shohim faqen 2, që në  
14 fakt përmenda fillimisht kur fola për këtë temë. Do ta lexoj  
15 që ta kemi për procesverbal. Nga fundi i faqes.

16 Py. Prapë këtu pyetja - këtu po flisnit, po tregonit që ishit  
17 ushtar i UÇK-së që nga '98-a dhe pyetja e gjykatësit hetues  
18 ishte:

19 "Cilat ishin detyrat tuaja?"

20 Dhe përgjigjja juaj ishte:

21 "Detyrat dhe detyrimet e mia ishin të njëjta si të gjitha  
22 detyrat dhe detyrimet për ofrimin e sigurisë për një person të  
23 rëndësishëm si Komandant Leka."

24 A është më e qartë tani çfarë nënkuptova unë me pyetjen  
25 time? Pra, a ju kujtohet ta keni thënë këtë provë, këtë

1 dëshmi?

2 Pë. Jo, s'më kujtohet se kanë kalu 20 vite, një, edhe e dyta  
3 unë po e konfirmoj edhe tash. Unë s'e di sa, sa ju po arrini  
4 me e kuptuet. Unë po jam shumë i kjartë.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull. Shkojmë pak më lart  
6 në faqen, në të njëjtën faqe. Lart në fillim të faqes.

7 Py. Po lexoj pyetjen e dytë që ju bëri gjykatësi hetues.  
8 Ishte në fillim të intervistës. Po flisnit, po tregonit që  
9 ishit ushtar i UÇK-së:

10 "Nuk kishit asnjë gradë aty?"

11 Dhe përgjigjja juaj ishte:

12 "Jo, nuk kisha asnjë gradë dhe asnjë nga anëtarët e tjerë  
13 të UÇK-së. Po unë isha i angazhuar të ofroja siguri për ish  
14 Komandant Lekën."

15 "Cili ishte emri i tij?"

16 "Nuredin Ibishi."

17 "Për cilën periudhë kohore po flisni?" është pyetja.

18 "Periudha 1998-1999."

19 Z. Dëshmitar, po lexoj fjalët tuaj. A ju kujtohet që keni  
20 thënë që një nga detyrat tuaja ishte të ofronit sigurinë. Pra  
21 të mbronit Nuredin Ibishin, përgjegjës për sigurinë e tij?

22 Pë. Jo, nuk më kujtohet se ka kalu 20 vite. Po megjithatë si  
23 gradë është e vërtetë. Unë u deklarova edhe sot që grada ma e  
24 madhe që ka ekzistue është ushtari i ushtrisë.

25 Py. Z. Dëshmitar, nuk ju pyeta për gradat. Thjesht një

1 përgjigje me po ose me jo. Kishit mundësinë t'i përgjigjeshit.

2 Tani mund të vazhdojmë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

4 Prokurore, dua t'i bëj unë një pyetje dëshmitarit.

5 Ajo që ju lexuam tani, që ishit i përfshirë për t'ju

6 ofruar sigurinë ish Komandant Lekës, Nuredin Ibishit. A është

7 e vërtetë apo jo që keni qenë përgjegjës për sigurinë e tij?

8 DËSHMITARI: Znj. Gjykatëse, nuk është e vërtetë që kemi

9 qenë sepse kurrkush nuk ka pasë siguri në kuptimin që ju po e

10 perceptoni. Ne kemi qenë 24 orë së bashku. Kemi lëvizë së

11 bashku dhe nëse mund të quhet kjo siguri, atëherë po. Por ne

12 kemi qenë 24 orë së bashku edhe i kemi ofru njeni tjetrit

13 siguri. Kemi qenë së bashku. Në çdo lëvizje, në çdo veprim

14 kemi qenë në terren, në fushëbeteja së bashku. Po të ishte me

15 i ofru siguri, sigurisht nuk ishte i plagosun.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ai

17 ishit ju badigardi, roja trupore e tij? Po apo jo?

18 DËSHMITARI: Jo, jo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Atëherë do të doja të dija nëse është në këtë deklaratë këtu

21 që thuhet, që janë fjalët tuaja, atëherë po na thua ti që ky

22 dokument ka keqinterpretuar atë që keni thënë ju. Janë

23 keqpërdorë ato që keni thënë ju? Pra janë të rreme, të

24 fabrikua këto që janë shkruar këtu? Këtë po na thoni?

25 Sepse këtu kemi një dokument zyrtar, ku thuhet se keni

1 thënë iks e ypsilon gjëra dhe nuk ka lidhje në mënyrën si i  
2 interpretoj unë gjërat. Janë fjalë për fjalë këtu dhe ju po  
3 thoni, "Jo, s'është e vërtetë." Po nga ky dokument duket se e  
4 ke thënë. Në dokument thuhet që e ke thënë. Pra ju po thoni që  
5 ky është një dokument - është e rreme kjo që është thënë këtu?

6 Apo s'e kuptova. Nuk isha aty në 2002-shin, thjesht po  
7 përpiqem ta kuptoj.

8 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare, e thashë edhe po e përsëris që  
9 këtë dokument...

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
11 lutem mos përsërisni asgjë. E kam pyetjen këtu. Ju mendoni që  
12 çdo gjë që është thënë këtu, atë që citova unë dhe znj.  
13 Prokurore, pra, janë të rreme apo ju kanë keqinterpretuar atë  
14 që keni thënë ju apo ka pasur një keqkuptim sipas jush?

15 DËSHMITARI: Unë s'mund të them, as të gjykoj, as të  
16 paragjykoj a është e rreme. Sigurisht këtu ka të pavërteta që  
17 thuhet. A ka të rrejtë ai a s'ka rrejtë unë nuk mund ta them  
18 atë, përderisa nuk më është ofru dokumenti në gjuhën amtare,  
19 në gjuhën shqipe që ta lexoj e ta firmosi e kam kontestu edhe  
20 në seancë të hapur publike. Atëherë si mund ta pranoj unë  
21 këtë?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
23 rregull.

24 Znj. Prokurore, vazhdoni.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e nderuar.

1 Py. Z. Dëshmitar, kjo është përsëritur disa herë në  
2 deklaratë. Kështu që po lexoj fillimin e faqes tjetër, thjesht  
3 për procesverbal, sepse ju pretendoni se gjërat mund të jenë  
4 keqinterpretuar, po ne fjalët tuaja po lexojmë.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3 në fillim,  
6 SPOE0030234 [sipas përkthimit].

7 Py. Po lexoj fjalët tuaja:

8 "Unë kujdesesha për sigurinë fizike të personit në  
9 fjalë." Po flasim për Komandant Lekën.

10 Pyetja e Gjykatësit hetues:

11 "Çfarë bëje?"

12 Përgjigjja juaj ishte:

13 "Nëse nuk ishte stërvitje ose detyra të tjera si ushtar,  
14 shkonim për të luftuar në beteja."

15 "Pra po luftoje në beteja apo ruaje Komandant Lekën?"

16 "Të dyja" - thua.

17 Këto janë fjalët tuaja z. Dëshmitar. A janë të vërteta  
18 apo jo?

19 Pë. Ky është konstatimi juaj sepse ju nuk keni qenë aty a i  
20 kam thonun a s'i kam thonun unë, po i mohoj.

21 Py. Më falni, z. Dëshmitar, nuk bëra asnjë vërejtje, asnjë  
22 konstatim nga ana ime.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

24 Py. Unë thjesht po ju pyes nëse fjalët që sapo ju lexova që  
25 ishin në fakt përgjigjet që i keni dhënë vetë Gjykatësit në

1 atë çështje. A janë të vërteta këto fjalë apo jo? Dhe ju lutem  
2 përgjigjuni me "po" ose me "jo."

3 Pë. Përderisa ju po thoni janë fjalët e juaja, ju sikur të  
4 ishit prezent aty. Unë e mohova jo një herë, po pesë herë a  
5 dhjetë herë. S'di qysh me kenë ma kjartë ndryshe. Ju sikur  
6 boni që keni qenë prezent.

7 Py. Pra po thua që nuk janë fjalët e tua këto këtu. Unë nuk  
8 bëra, nuk sajova asgjë. Ti po thua që këto nuk janë fjalët e  
9 tua. A po thoni këtë apo jo e do vazhdojmë?

10 Pë. Nuk e di kush po sajon këtu. Unë e thashë. Përderisa nuk  
11 më është ofrue dokumenti në gjuhën shqipe me e lexue dhe me e  
12 nënshkrue, atëherë ky për mue s'ka vlerë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
14 ju takon ju. Për ne është në Gjykatë edhe thuhet që këtu është  
15 emri juaj dhe ju ishit një dëshmitar në atë çështje. Pra është  
16 -- ka vlerë në këtë moment, në këtë Gjykatë. Ju kemi këtu dhe  
17 ne duhet ta diskutojmë këtë gjë. Nuk ju takon ju të vendosni  
18 të përgjigjeni ose jo. Dhe po ju pyes: A janë këto fjalë, a  
19 janë fjalët e tua apo jo? E ke thënë diçka të ngjashme apo jo?

20 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare, përderisa nuk i kam pasë në  
21 gjuhën amtare, atëherë nuk mund t'i konfirmoj janë apo nuk  
22 janë të miat. Me vetë faktin që kam refuzue edhe e kam paraqit  
23 edhe para Trupit Gjykues që është mbajt në Prishtinë edhe e  
24 kam kontestue edhe atëherë, e kontestoj edhe tash. Ma thjesht  
25 s'di qysh me u përgjigj.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua  
2 t'i përgjigjem - më fal - do të doja që t'i përgjigjeshit  
3 pyetjes nëse keni qenë bodigardi i tij? Ju thua jo, po "Gjatë  
4 gjithë kohës isha me atë dhe ne mbronim njëri-tjetrin, pra,  
5 ishim përgjegjës për sigurinë e njëri-tjetrit." Këtë po na  
6 thua tani?

7 DËSHMITARI: 24 orë e thashë kemi qenë së bashku, por jo  
8 vetëm unë, po çdo ushtar ka qenë 24 orë, ka qenë në mbrojtje  
9 të njoni-tjetrit. Sepse vija e frontit është detyrim me e  
10 mbrojt ushtari ushtarin. Nëse ju e quani. Quani qysh të doni,  
11 me çfarë termi e quani, atëherë është e drejtë e jueja. Unë  
12 vetëm e kontestova që nuk mu është ofrue në shqip.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
14 Dëshmitar, këtë s'po e përkthuj me fjalët e mia. Po përdor  
15 fjalët e tua. Megjithatë po ia jap fjalën znj. Prokurore tani.  
16 E bëtë të qartë pikëpamjen tuaj.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do vazhdoj më tej.

18 Py. Z. Dëshmitar, a mbetët në kontakt me z. Nuredin Ibishi  
19 pas luftës ju? Kishit ende kontakt?

20 Pë. Po, sigurisht që po.

21 Py. E takoni kështu si mik nga ana shoqërore?

22 Pë. E takoj si bashkëluftëtar, si mik, si komandant.

23 Py. Sa shpesh takoheni në përgjithësi?

24 Pë. Nuk mbaj evidencë.

25 Py. A keni folur me të së fundmi apo jeni takuar me të së

1 fundmi?

2 Pë. Specifikisht, kur? Nëse të intereson thuje kohën? Se  
3 fundi mundet me qenë së fundi para një muaji, para një viti,  
4 para dy muajve, para dy dite, para dhjetë dite, specifikoje  
5 kur.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
7 lutem përgjigjuni pyetjes.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

9 Py. Kur ishte hera e fundit që jeni takuar me z. Nuredin  
10 Ibishi? A mund të na thoni?

11 Pë. Ndoshta dhjetë ditë, dy javë. Dhjetë ditë.

12 Py. Po para kësaj herës së fundit kur jeni takuar?

13 Pë. Po s'kam mbajtur shënim, e nderuar Gjyqtare, s'kam mbajtur  
14 shënim sa herë takohemi. Ne takohemi edhe në kalim e sipër,  
15 takohemi në përvjetore, takohemi për festa fetare, për festa  
16 kombëtare.

17 Py. A e konsideroni z. Ibishi një mik të tuajin?

18 Pë. Edhe ma tepër sesa mik. Por jo vetëm Komandant Lekën.

19 Py. Në rregull. A e dinit ju që z. Ibishi po ashtu ka dhënë  
20 deklaratë për Mbrojtjen, për z. Salih Mustafa?

21 Pë. Jo, nuk e di unë që ka dhënë, s'e di.

22 Py. A keni folur me z. Ibishi pasi dhatë ju deklaratën për  
23 Mbrojtjen e Salih Mustafës, keni folur me të?

24 Pë. Unë kam folë, po çka specifikisht po të intereson ty -  
25 pyetje konkrete. Unë kam folë edhe foli prapë.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
2 lutemi përgjigjuni pyetjes: A keni folur me z. Ibishi pasi i  
3 keni dhënë dëshminë Mbrojtjes së z. Salih Mustafa? Ju mund t'i  
4 përgjigjeni kësaj pyetjeje.

5 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare, unë e pohova që po, por varet  
6 çka - cila ka qenë biseda shtrohet pyetja nëse don  
7 konkretisht? Por kjo asht e gjonë.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

9 Py. Dakord. Ta shohim. Pra ju thatë që keni folur me të pasi  
10 dhatë dëshminë. A ishte kjo menjëherë pasi i keni dhënë  
11 deklaratën Mbrojtjes së z. Salih Mustafa apo jo? Kur nëse ju  
12 kujtohet?

13 Pë. Jo, as s'e di kur. S'e di.

14 Py. Menjëherë, pak kohë mbasi e dhatë atë deklaratë apo jo?

15 Pë. Po s'e kam regjistru atë se s'ka qenë për mu, ajo  
16 irelevante ka qenë kur kam bisedue. Kur jam takue, jemi ul,  
17 kemi pi kafe, kemi bisedue, kemi ndejt.

18 Py. A e keni diskutuar me të faktin që ti i ke dhënë  
19 deklaratë Mbrojtjes së z. Mustafa apo jo?

20 Pë. Jo, as më ka pyet e as s'i kam tregu.

21 Py. A keni biseduar me ndokënd tjetër në përgjithësi lidhur  
22 me faktin që i keni dhënë deklaratë Mbrojtjes së z. Salih  
23 Mustafa?

24 Pë. S'më kujtohet, s'e di. Ka edhe mundësi, po s'e di, s'më  
25 kujtohet.

1 Py. Përse thoni "ka mundësi"? A ju kujtohet që ka ndodhë një  
2 gjë e tillë apo jo?

3 Pë. S'më kujtohet. Po s'e përjashtoj një mundësi sepse s'kam  
4 qenë i msheftun, kam qenë i hapur, jam transparent. S'kam  
5 arsye edhe pse me u mshef, por nuk e di, s'më kujtohet. Një  
6 rast konkret -- po të më kishin pyet bashkëluftëtarët  
7 sigurisht do ju tregojsha.

8 Py. Do t'ju kishit treguar çfarë?

9 Pë. Që kam dhënë dëshmi.

10 Py. A keni diskutuar me ndokënd tematikën apo çështjet që  
11 janë diskutuar në këtë deklaratë, në këtë deklaratë që keni  
12 dhënë për Mbrojtjen pra?

13 Pë. Jo, sepse s'më kanë pyet. Po të më kishin pyet, sigurisht  
14 që po e kisha trajtu.

15 Py. Kur thoni që nuk të kanë pyet. Për kë e ke fjalën? Për  
16 njerëz në përgjithësi, për kë e keni fjalën?

17 Pë. Për gjithë ata bashkëluftëtarë që jam taku me ta.

18 Py. Kush janë këta bashkëluftëtarë që keni takuar?

19 Pë. Janë të shumtë.

20 Py. A mundet të përmendni emrat që ju kujtohen?

21 Pë. Ka shumë. Janë me dhjetëra, qindra në përvjetor, në një  
22 manifestim qofshin ata. S'kam mbajtur shënime cilët kanë qenë  
23 aty. Shumicës edhe ja kam harru edhe emrat, po në figurë i  
24 njof.

25 Py. Nuk ju kujtohet asnjë emër?

1 Pë. Po asnjë emër, s'po di emën i përveçëm, s'di cilën me  
2 thonë. Mund ta them ndonjë që bo vaki e s'ka qenë aty hiç. Po  
3 s'më kujtohen tash sepse ka qenë, s'kanë qenë me një a dy po  
4 kemi qenë shokë, bashkëluftëtarë.

5 Py. Kush janë këto bashkëluftëtarë me cilët jeni takuar kaq  
6 shpesh?

7 Pë. Të gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,  
8 qofshin të zonës operative të Llapit, qofshin edhe të zonave  
9 të tjera.

10 Py. Për shembull?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, desha t'i  
12 bëja një pyetje.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të  
14 marrim përgjigjen për këtë pyetje njëherë. Nuk shoh arsye se  
15 përse të ndërhysh tani. Mund t'i bëni komentet tuaja gjatë  
16 seancës së ripyetjes. Dua të dëgjojmë përgjigjen për pyetjen  
17 që i është bërë lidhur me bashkëluftëtarët.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Çështja ishte nëse atij i  
19 kujtohej nëse ka biseduar lidhur me përmbajtjen e deklaratës  
20 së tij për palën Mbrojtëse dhe kësaj i ka dhënë përgjigje. Dhe  
21 më pas ishte një pyetje hipotetike se, "Çfarë nënkuptoni me  
22 bashkëluftëtarë. Kush janë bashkëluftëtarët?" Dhe nuk shoh seç  
23 lidhje ka kjo me dhënien e deklaratës që i ka dhënë palës  
24 Mbrojtëse, ZPS-së, apo kujtdo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

1 vazhdojmë. E shoh unë se është me vlerë.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

3 Py. Pra, dëshmitar, a mund të na jepni disa nga emrat e  
4 bashkëluftëtarëve që ju kujtohet që t'i keni takuar?

5 Pë. Jo mo, s'kam mbajtur shënim unë cilët i kam takue. Janë  
6 konë me dhjetëra.

7 Py. Ato që ju kujtohen. Nuk ka nevojë që të jepni tërë  
8 listën. Vetëm ato që ju kujtohen.

9 Pë. Ka pasë shumë, ka pasë të yonës së Shalës, ka pasë të  
10 zonës së Drenicës. Kemi shkue në ngushëllime për nanën e  
11 zotëri Kadri Veselit. Kur i ka vdekë kemi shkue mbi njëqind  
12 vetë. S'po di unë cilën me thonë që ky asht që ky aty. Kemi  
13 shku në mënyrë të organizume prej shoqatave të organizume dhe  
14 kemi shku në vizitë.

15 Py. Në faqen 99, rreshti 5, ju përmendët ushtarët e UÇK-së  
16 nga Zona Operative e Llapit dhe zonat e tjera. Pra më lejoni  
17 që të përqendrohëm tek ushtarët e UÇK-së të Zonës Operative të  
18 Llapit që i keni përmendur. A mund të na jepni disa nga emrat  
19 e atyre të cilët i keni takuar?

20 Pë. Por jo mo s'i mbaj mend tash se s'kam pasë, s'ka qenë  
21 interesi i jemi me ditë cilli asht aty. Kam harrue, nuk asht  
22 dje që ka ndodhë ose pardje.

23 Py. Pra ju thoni që nuk ju kujtohet asnjë emër? Këtë po  
24 thoni?

25 Pë. Po unë muj t'i përmendi dhjetë-pesëmbëdhjetë. Mund të mos

1 kenë qenë ata aty. Sepse s'bahet fjalë për tre ose katër, mund  
2 të jenë tridhjetë e pesëdhjetë e shtatëdhjetë e njëqind e  
3 treqind. Tash s'po di unë cillin. S'kam mbajtur evidencë cillin  
4 po e takoj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
6 Prokurore, ta ndalojmë në këtë pikë.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

8 Py. Për sa i përket z. Mustafa, a keni mbajtur kontakte me të  
9 pastaj përfundimit të luftës?

10 Pë. Jo, shumë rrallë. E keni fjalën për Salih Mustafën?

11 Py. Po, z. Salih Mustafa.

12 Pë. Jo, rrallë, përveç në përvjetore që jemi takue, në  
13 manifestim edhe ka qenë një - nëse s'gaboj se ka qenë kohë e  
14 gjatë - në '99-n, dikund apo në 2000. S'më kujtohet se asht  
15 thjesht një darkë që e ka organizue KFOR-i edhe kemi qenë të  
16 gjithë së bashku, përndryshe jo.

17 Py. A e keni kontaktuar atë pasi është arrestuar?

18 Pë. Edhe njëherë se s'kuptova?

19 Py. A keni patur kontakt me të pas arrestimit të tij?

20 Pë. S'kam pasë mundësi se po të kisha mundësi po do ta  
21 kontaktojsha për çdo ditë.

22 Py. A keni patur ndonjë kontakt me ndonjë nga anëtarët e  
23 familjes të Salih Mustafës pastaj arrestimit të tij?

24 Pë. Po, kam pasë.

25 Py. Me kë?

1 Pë. Me vëllaun e Salih Mustafës.

2 Py. A mund të na jepni emrin?

3 Pë. Ben i thonë shkurt. S'e di qysh e ka emnin.

4 Py. Z. Arben Mustafa?

5 Pë. S'po di, ndoshta Arben e ka, s'e di. Unë e kom kontaktue  
6 sepse ka pasë -- më vjen keq që është prezent Salihi këtu - po  
7 e ka pasë babën sëmut. Edhe djali im i madhi është magjistër  
8 farmacist, punon në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë.  
9 Ka kërku ndihmë që t'i dalim ndihmë me disa barna, në mungesë  
10 të barnave në spital edhe e kam kontaktue. Aq sa kam pasë  
11 mundësi kemi bo përpjekje me e ndihmue. Kaq.

12 Py. Si keni reaguuar ndaj lajmit të arrestimit të z. Salih  
13 Mustafa?

14 Pë. Keq.

15 Py. A mund të jepni hollësi të tjera?

16 Pë. Çka konkretisht po të intereson? Me vetë faktin që thashë  
17 "keq", s'e kemi pranuar mirë, sepse ne e konsiderojmë edhe  
18 mendojmë që është ba arrestimi i padrejtë, me sajesa.

19 Py. A i keni ndjekur procedurat e kësaj çështjeje?

20 Pë. A është e ndalume?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është  
22 thjesht një pyetje z. Dëshmitar. Është një pyetje. Nuk ka të  
23 bëjë me ndalesa apo jo, me ndalime apo jo. A i keni ndjekur  
24 apo jo.

25 DËSHMITARI: I ka ndjekë gruaja. Edhe kur kam shku në

1 mbrëmje çdo herë, mi ka interpretue sepse është gjuhëtare. Më  
2 ka tregue edhe i kemi diskutu me të gjerë e gjatë. Ajo ka pasë  
3 kohë ma tepër. Po edhe unë kur kam pasë kohë i kam përcjell.  
4 Po gruaja i ka përcjellë vazhdimisht edhe i përcjell.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

6 Py. Edhe kur ju vetë i keni përcjellë këto procedura, a ju  
7 kujtohet se cili dëshmitar apo cilën pjesë të procedurave i  
8 keni ndjekur vetë?

9 Pë. Jo, unë pjesërisht se jam në punë tetë orë, jam në punë  
10 prej tetve deri në katër. Jam në punë edhe s'kam mundësi. Por  
11 aty ku kam pasë mundësi q'atë pjesë edhe pse fatkeqësisht ju  
12 po thirrni që është transparente, shumica e kohës po është e  
13 mbylltë - të paktën q'ashtu interpretimi edhe transmetimi  
14 është në Kosovë. Por pjesën tjetër ma ka interpretue gruaja në  
15 shtëpi çka ka ndodhë në do seanca.

16 Py. Po sesionet e dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes të cilët  
17 kanë dhënë dëshmi përpara jush këtu, a i keni ndjekur ato?

18 Pë. Jo, unë konkretisht jo asnjëherë. Ka ndodhë edhe i kam  
19 përcjellë 15 minuta ose në fund q'ato që kena pasë mundësi.

20 Por thashë edhe po jua ripërsëris. I ka përcjellë gruaja ime  
21 thuajse 90 për qind. Edhe i kemi diskutuar në mbramje tu pi  
22 kafe, tu bisedue, kjo. Por edhe unë kur kam pasë mundësi i kam  
23 përcjellë. Nëse është e ndalume, thujm na.

24 Py. Kur thatë që arrestimin e z. Mustafa e keni, e quani të  
25 padrejtë, për se e thoni? Çfarë nënkuptoni me të?

1 Pë. Unë u shpreha, e thashë shumë kjartë. Mendojmë që është i  
2 padrejtë sepse nuk ka bazë edhe nuk ka fakte. Ne mendojmë që  
3 janë të gjitha sajesa edhe me gënjeshtër të dëshmitarëve të  
4 rrejshëm dhe të Prokurorisë së Serbisë, që fatkeqësisht ju  
5 edhe e keni dekorue. I keni dhënë edhe dekorata atyne  
6 bashkëpunëtorëve të tyne. Ata që na kanë vra, na kanë djegë  
7 edhe na kanë pjekë. Ju me ta keni bashkëpunue edhe ata i keni  
8 dekorue.

9 ZNJ. D'ASCOLI: Të nderuar Gjykatës, po konsultoj për disa  
10 çaste kolegët e mi.

11 [Prokurorët e Specializuar këshillohen]

12 ZNJ. D'ASCOLI: Të nderuar Gjykatës, nuk kam pyetje të  
13 tjera për dëshmitarin.

14 Py. Z. Parduzi, faleminderit për përgjigjet që i dhatë  
15 pyetjeve të mia.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
17 Faleminderit, znj. Prokurore.

18 Tani e ka radhën Mbrojtësja e Viktimave.

19 Znj. Mbrojtëse, a keni pyetje për të bërë nga ana juaj?

20 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Po, faleminderit. Jo, nuk  
21 kemi pyetje për t'i bërë këtij dëshmitari, e nderuar  
22 Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Faleminderit.

25 Pala Mbrojtëse, a dëshironi të vazhdoni me pyetjet shtesë



1 për këtë dëshmitar?

2 Z. SHALA: Jo, faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit, Avokati i Mbrojtjes.

5 Përpara se të pyes kolegët e mirë të Trupit Gjygues nëse  
6 kanë pyetje të tjera, dua t'ju jap juve mundësinë që të  
7 shprehni shqetësimin që kishit z. Parduzi.

8 DËSHMITARI: Mundem?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
10 vazhdoni. Në varësi të asaj që doni të thoni seanca do të jetë  
11 publike ose mund të jetë edhe private, por fillimisht do të  
12 dëgjojmë se ç'keni për të thënë.

13 DËSHMITARI: Falemnders për mundësinë. Kam dy shqetësime.  
14 Një ka të bajë me qasjen time nga ana e Prokurorisë edhe pse e  
15 kanë ditë që unë jam dëshmitar i Mbrojtjes, me kanë ftue në  
16 dhjetor 2021 dhe jam intervistue më 10 apo 11 janar të 2022-  
17 tit. Konsideroj se osht bo një trysni ndaj meje dhe tërësisht  
18 është e padrejtë. Nëse i referohemi ligjeve të Kosovës që këta  
19 zotërinj të thirren, atëherë mbi bazën e kodit të procedurës  
20 penale nuk kanë të drejtë në fazën Prokuroria që të merr  
21 dëshmitarët e Mbrojtjes në pyetje ose e kundërta.

22 Edhe çështja e dytë, e kjo sigurisht që don një sqarim.  
23 Dhe çështja e dytë, znj. Gjyqtare, ftesat të cilat na bohen  
24 për dorëzimin e pashaportave për marrjen e vizave për të  
25 udhëtuar në Hagë, bohet në mënyrë -- po e them ma...

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
2 falni. Për këtë pikë ne do ta diskutojmë në çështje të hapur.

3 Të kalojmë në seancë të mbyllur.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë të

25 hapur të nderuar Gjykatës.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 E kam lexuar dëshminë tuaj për Prokurorinë, z. Parduzi  
4 dhe atë që ju i thatë Prokurorit. Ajo që ju i thatë apo i  
5 treguat Prokurorisë, a ishte e saktë?

6 DËSHMITARI: Po edhe njëherë a ka mundësi pyetjen, cilla?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta  
8 riformuloj. Ndoshta pyetja ishte shumë e gjatë. Ju thoni që ju  
9 kanë ushtruar presion apo trysni për t'i dhënë dëshmi Zyrës së  
10 Prokurorit të Specializuar, kështu është?

11 DËSHMITARI: Unë e kam kuptue dhe e konsideroj që është  
12 ashtu. Sepse në fakt sjellja e tyre ka qenë korrekte s'mund të  
13 them - mrena objekteve jam trajtu mirë. Por me vetë faktin që  
14 jam ftue që të jap deklaratë edhe Prokurorisë, unë e  
15 konsideroj që edhe lloj frike edhe lloj trysnie, kështu e  
16 konsideroj unë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
18 deklarata që ju keni dhënë për ta, a ishte vullnetare?

19 DËSHMITARI: Po, sepse unë e kam mendue që më kanë ftue  
20 edhe po tregojnë sepse unë axhën e kam të zhdukun ende. E kam  
21 mendue që e kanë gjetë, e kanë zbulu një varrezë masive në  
22 Serbi që fatkeqësisht kemi ende kufoma. Janë mbi 1,600 që nuk  
23 na kthehen. E kam mendue që ka ndonjë risi edhe për atë kam  
24 pranë, përndryshe s'isha shkue. Unë kam mendu që kanë zbulue  
25 diçka. Ka ndonjë informacion të ri rreth varrezave masive edhe

1 gjetjet e trupit të axhës tim.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ju  
3 kanë detyruar që të flisni, të jepni deklaratë?

4 DËSHMITARI: Jo, përveç Gjykatës që jam nën betim, s'mund  
5 me më detyron askush me folë. E kam shpreh këtë shqetësim edhe  
6 para tyre atje.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Pra çfarë  
8 komenti keni për të bërë? Çfarë doni të ngrini, çfarë çështje  
9 doni të ngrini?

10 DËSHMITARI: Që kjo mos të vazhdojë në të ardhmen sepse  
11 kur ndodhë me mue, sigurisht ka me ndodhë edhe me të tjerë  
12 dëshmitarë. Kjo praktikë duhet të ndërpritet. Unë mendoj edhe  
13 konsideroj kështu. Prandaj kërkova sqarim. Edhe për mu është  
14 shqetësim. Është shqetësuese përderisa po të isha dëshmitar i  
15 Prokurorisë atëherë sigurisht nuk i isha përgjigj. Me çfarë të  
16 drejte ana e Mbrojtjes do të më ftonte? S'muj me qenë edhe i  
17 Prokurorisë edhe i Mbrojtjes, veç në raste kur vetë Gjykata  
18 vendos ndryshe. Pa vendim të Gjykatës konsideroj që është  
19 totalisht shkelje e rregullt edhe e ligjit. Aq ma tepër nëse i  
20 referohem ligjit të Kosovës.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
22 pyetja e fundit që kam për momentin është: A u përpoqët t'i  
23 tregonit Prokurorit të gjitha gjërat me aq sa ju janë kujtuar  
24 dhe duke treguar vetëm të vërtetat?

25 DËSHMITARI: Në fakt jo Prokurorit, po Prokurorëve sepse

1 ka qenë zonja edhe zotëria. Kam bo përpjekje dhe të gjitha ato  
2 që i kam thonë, i kam thonë me sinqeritetin ma të madh,  
3 pavarësisht që s'kam qenë nën betim.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I  
5 kemi dëgjuar shqetësimet tuaja z. Dëshmitar. A doni të shtoni  
6 ndonjë gjë pa patur nevojë për të përsëritur veten. Jo.  
7 Dakord.

8 Tani po i hedh sytë nga kolegët e mi në të djathtë. A  
9 keni pyetje për të bërë? Në të majtë.

10 Po, ju e keni fjalën.

11 Pyetje Trupi Gjykes:

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Parduzy, në deklaratën që  
13 i keni dhënë palës Mbrojtëse, prova DSM00043 ju thatë si më  
14 poshtë:

15 "Nga spitali u transferova në Zllash dhe u transportova,  
16 më transportuan në Zllash ku ndodhej Saliu." [sipas  
17 përkthimit] A e keni thënë këtë?

18 Pë. E kam thonë edhe para se me shku në Zllash që në Popovë e  
19 kemi kaluar një rrugëtim. Por, "po, kam qëndrue në Zllash".

20 Py. Fundi i fjalisë thotë, "...ku ndodhej Saliu." Pra fundi i  
21 fjalisë thotë, "...ku Saliu ishte i vendosur" [sipas  
22 përkthimit]. Deklarata juaj a do të thotë që Saliu [sipas  
23 përkthimit] ka qenë në Zllash në atë kohë?

24 Pë. Nuk e di ku ka qenë i vendosur, po e di që e kam takue  
25 dhe na ka ndihmue dhe na ka sigurue rrugëtimin për me kalue në

1 Maqedoni për shërim. Ka qenë aty sepse ne e kemi - ku kemi  
2 mujt jemi vendos. Çdo shtëpi ka qenë një lloj kazerme, po  
3 thjesht nuk kemi pasë vendqëndrim të caktum. Nuk mund ta them  
4 këtë edhe nuk e di.

5 Py. Atëherë përse keni thënë atë që Saliu ishte i vendosur në  
6 Zllash?

7 Pë. E kam thonë e kam takue në Zllash, jo i vendosun se nuk e  
8 di ku. S'kam mbajjt evidencë ku ka qenë, a ka qenë i vendosun  
9 aty a jo.

10 Py. Por unë lexova fjalët tuaja. Fjalët tuaja ku thuhet që:  
11 "Saliu ishte i vendosur..." Megjithatë, do kaloj në një temë  
12 tjetër.

13 Pasi jeni plagosur në periudhë të '99-s, a ishit në  
14 gjendje të ecnit me këmbët tuaja?

15 Pë. Jo.

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në faqen 23, rreshtat 23-24,  
17 ju përmendët rekrutët të cilët kanë përfunduar stërvitjen e  
18 tyre edhe thatë që një numër prej tyre kanë shkuar tek njësit  
19 i Mustafës. Për cilin e kishit fjalën? Për cilin njësit?

20 Pë. Zotëri Gjyqtar, nuk thashë kanë shkuar. Thashë mund të  
21 jetë shkuar ndonjë. Por nuk e di sa kanë shkue edhe nuk e di  
22 kush ka shkue. Një pjesë e madhe është sistemue nëpër brigada  
23 e brigada - brenda brigadave s'ka pasë - u konë togu,  
24 kompania. Por nuk e di a kanë shkue -- sigurisht ka shkue  
25 ndonjë - s'e di.

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pyetja ime nuk ishte sesa  
2 shkuan. Unë citova atë që thatë ju "mbase disa prej tyre  
3 shkuan." Ti the, "Mbase disa prej tyre shkuan te njësitit i  
4 Mustafës." Për cilin njësit e kishe fjalën?

5 Pë. Njësia që ka qenë e formume në Zllash, në pjesën e  
6 Gollakut.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Emrin, si e kishte emrin  
8 njësitit?

9 Pë. Në atë kohë e ka mbart emrin BIA.

10 GJYKATËSI BITTI: Në rregull. Dhe ky ishte njësitit i z.  
11 Salih Mustafa apo jo?

12 Pë. Nuk ka qenë - në kuadër të brigadës apo të asaj pjese nuk  
13 e di. Po s'ka qenë personalisht i z. Mustafa se s'ka pasë  
14 private njësit.

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] E qartë, e qartë, e kuptoj  
16 këtë. Po mendoj që ajo që doni të shprehni ju - dhe mund ta  
17 kem gabim, më korrigjoni - është, doni të thoni që z. Salih  
18 Mustafa ishte komandanti i këtij njësitit. A doni të thoni këtë  
19 kur thoni ju njësitit i Mustafës? Këtë doni të thoni që qe  
20 komandanti?

21 Pë. Por a ka qenë komandanti a jo, nuk e di unë. Unë e di që  
22 ka pasë brigada edhe ka qenë një kohë zëvendës i asaj brigade  
23 153 Fatmir Sopi. Më vonë ka ardhë zotëri Adem Shehu. Qysh ka  
24 qenë i rregullum njësitit aty mrena brigadës nuk e di. Por e di  
25 që njësitit BIA e ka marrë sepse ka veprue ilegalisht edhe në



1 qytet, në Prishtinë. Ka pasë për detyrë të na furnizojë me  
2 artikuj ushqimorë, veshmbathje, barna, sjelljen e mjekëve e  
3 gjana ushqimore, çka ka pasë nevojë - logjistikë thjesht.

4 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Kur shkua tek  
5 shtabi i Brigadës 153 në Zllash, ju folët me ata, pra ju  
6 përmendni shtabin në faqen 24 të transkriptit, rreshtat 9 deri  
7 në 12 dhe thoni si në vijim: "Disa individë ishin atje," edhe  
8 i referoheshe Fatmir Sopit. Pastaj thua: "Ndërkohë... edhe  
9 Mustafa erdhi këtu."

10 Çfarë doni të shprehni ju kur thoni këtë? Pra që Salih  
11 Mustafa nuk qëndronte në shtabin e Brigadës 153, ndryshe nga  
12 Fatmir Sopi pra që qëndronte atje?

13 Pë. Zotëri Gjyqtar, nuk e di a ka ndejt edhe Fatmiri aty, por  
14 besoj që të gjithë kanë lëvizë. Ka mujt mos me qenë për  
15 momentin aty as Fatmiri, as Salihi e shumë të tjerë. Por  
16 ndërkohë kanë ardhë për një detyrë, për një obligim, për një  
17 caktim, nuk e di.

18 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Mirë, faleminderit. Kur u  
19 larguat nga Potoku në fund të prillit, na thatë se fillimisht  
20 shkua në Rimanishte dhe pastaj në Zllash. Faqja 31, rreshtat  
21 11 dhe 12 të transkriptit. Dhe thatë: "...na çuan, na  
22 transportuan në - ata na transportuan në Rimanishte dhe në  
23 Zllash." Kush janë ata? Kush ju transportoi ju?

24 Pë. Fillimisht një korrigjim. Nëse është bo lëshim e kam  
25 dhonë në Popovë e nga Popova kemi kaluar në atë pjesë anejna

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Kapllan Parduzi (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 122

1 ku është. Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare sigurisht se askush  
2 tjetër, tu ndihmue edhe mbrojtja civile territoriale.

3 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit z.  
4 Parduzi.

5 Znj. Kryegjykatëse, nuk kam pyetje të tjera.  
6 Faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
8 Parduzi, arritëm në fund të dëshmisë suaj. Do të doja t'ju  
9 falënderoja për përpjekjet tuaja, për dëshminë që na dhatë e  
10 cila besoj se do ta na ndihmojë që të gjejmë të vërtetën.  
11 Faleminderit shumë. Ju urojmë rrugë të mbarë.

12 Dhe ju kujtoj se nuk duhet ta diskutoni dëshminë që keni  
13 dhënë para Dhomave të Specializuara me askënd. Faleminderit  
14 edhe njëherë.

15 DËSHMITARI: Falemnders edhe juve.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Faleminderit, Asistente e Gjykatës.

19 Ora është 3 e gjysmë. Para se ta ndërpresim seancën dhe  
20 të vazhdojmë nesër, a ka ndonjë gjë për të shtuar palët para  
21 Trupit Gjykues?

22 Fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Asgjë prej nesh.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Mbrojtësja e Viktimave.

1 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Asgjë prej nesh.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokati Mbrojtës, fjala është për ju.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Asgjë as nga ana jonë.

5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të

7 mblidhemi nesër, e martë, 12 prill, në orën 9.30 me dëshminë e

8 Dëshmitarit 1000.

9 Seanca mbyllet.

10 --- Seanca mbyllet në orën 15.36.

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25